



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2024, ora 13:00

TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE VI

Drejton tryezën: Juelda Lamçe

Rendi i ditës:

Funksioni ligjvënës dhe forcimi i rolit të Kuvendit për zbatimin e ligjeve, si dhe efektiviteti, transparencia dhe llogaridhënia e vetë Kuvendit.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Klotilda Bushka, Genci Gjonçaj, Julia Çela, Julia Done, Merita Qato, Mimoza Arbri dhe Elda Zenelaj.

Të ftuar:

Aurela Anastasi, Erinda Ballanca, Iris Luarasi, Rinor Beka, Blerina Celoaliaj, Majlinda Dhukaj, Mirela Arqimandriti, Besnik Dervishi, Evin Gjevori, Migena Kondo, Agim Rrapaj, Mariel Frroku, Gledis Gjipali, Vangjel Demi, Klesta Hysi, Agnus Bernhard, Mauro Puzzo, Majlida Dhuka, Klodiana Vogli, Taulant Balla, Ilvana Dedja, Arvena Deda, Teisa Kurti, Isabele Thomas Delic, Kristian Lika, Xhejni Ruli, Migena Kondo, Emilio Çika, Laureta Memo, Blerina Cenoaliaj, Reald Keta, Erinda Lala, Roland Stafa, Loren Kaçollari, Stela Suloti, Juljan Hysomema, Serona Kolaveri, Oltian Andrea, Albina Musarj, Ardita Seknaj, Endri Teta, Holta Muka, Ema Kovanoj, Esmeralda Hoxha dhe Marcela Muke.

HAPET MBLEDHJA

Juelda Lamçe – Faleminderit për pjesëmarrjen!

Sot prezantojmë gjetjet e grupit të ekspertëve të lartë të shtyllës së sundimit të ligjit, funksionin ligjvënës dhe forcimin e rolit të Kuvendit për zbatimin e ligjeve, si dhe efektivitetin, transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit.

Unë quhem Juelda Lamçe, jam dekane e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin European të Tiranës.

Në këtë panel sot kemi të ftuar profesoreshë Aurela Anastasin dhe dy kolegët e grupit të punës, të cilët janë marrë efektivisht me çështjet që i përkasin transparencës dhe llogaridhënies së Kuvendit. Secili prej tyre do të japë gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Ne jemi këtu për t'u dhënë përgjigje pyetjeve tuaja. Shpresojmë që kjo tavolinë t'i shërbejë thellimit të analizës që i është bërë të gjithë dokumentacionit që na është vënë në dispozicion, duke pasur parasysh jo vetëm raportet vendase ndërkombëtare, por mbi të gjitha qasjen ndaj nevojave të qytetarëve.

Fjala është për profesoreshë Aurela Anastasin, profesoreshë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Departamenti i të Drejtës Publike.

Faleminderit!

Aurela Anastasi – Përshëndetje!

Faleminderit, Juelda!

Unë dua të bëj një prezantim të shkurtër të gjetjeve të grupit të punës, që ka punuar për analizën lidhur me funksionin ligjvënës të Kuvendit. E gjithë kjo është parë në kuadrin e parimit të sundimit të ligjit ose siç e kemi ne në kuadrin e parimit të shtetit të së drejtës. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Kështu e ka përkufizuar Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parimin e shtetit të së drejtës ose sundimin e ligjit.

Cili ishte qëllimi ynë? Ne programuam disa qëllime kryesore, të cilat erdhën duke u përforcuar ose duke u shtuar, por sidoqoftë synojmë forcimin e funksionit ligjvënës të Kuvendit, përmirësimin e procesit ligjvënës në kuadrin e respektimit të Kushtetutës, rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjen e publikut në këtë proces, forcimin e kontrollit parlamentar për zbatimin e ligjit, forcimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale për një proces ligjvënës të rregullt dhe efektiv, ku

përfshihen mjaft elemente. Ndërmjet tyre kemi një sërë elementesh, por në mënyrë veçantë do të përmend aspektin e analizës antikorruption në kuadrin e propozimit të ligjeve dhe të gjithë procesit ligjvënës.

Metodologjia.

Metodologjia kryesore është një analizë kryesisht *desk-study*, domethënë rishikim i literaturës ekzistuese dhe krahasimore. Pa dyshim, analiza krahasimore jep një ndihmë në këtë kuadër. Mund të përmend raportin e Komisionit Europian, për shqyrtimin analitik për grupin e kapitullit të parë “Themelorët”, publikuar më 24 korrik të vitit 2023, Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike, Planin e Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, që është miratuar nga Konferenca e Kryetareve në vitin 2024, raportin vjetor të Kuvendit për vitin 2023, disa akte të miratuara nga Byroja e Kuvendit në lidhje me transparencën, si dhe mjaft ndihmuese kanë qenë raportet e organizatave të shoqërisë të civile.

Në kuadër të çështjeve kryesore që janë trajtuar, ju ndoshta njihni procesin, ka pasur një unifikim të tyre, ndaj jemi përqendruar në çështjet e unifikuara për të gjitha grupet, dhe pastaj në nënçështjet që janë zbërthyer në kuadër të tyre.

Në këtë kuadër kemi punuar për të parashtruar progresin dhe arritjet e Kuvendit. Kjo ishte më se e domosdoshme për të parë pikën e nisjes dhe premisat nga do të niseshim, pastaj problemet dhe sfidat, çështjet për zgjidhje, drejtimet kryesore të ndërhyrjeve, pa pretenduar se i kemi thënë të gjitha drejtimet e ndërhyrjeve apo çështjet për zgjidhje, por sidoqoftë janë premisa të mira për të diskutuar dhe për të debatuar me qëllim që të përmbushen dhe të plotësohen në të ardhmen.

Pikë tjetër shumë e rëndësishme janë çështjet për diskutim nga publiku. Në progresin dhe arritjet e Kuvendit kemi përzgjedhur disa prej tyre për t’i parashtruar përpara jush. Për shembull, të përmendim si një arritje faktin që (në parantezë dua të them që kemi marrë të dhëna vetëm për vitin 2023, në lidhje me këtë çështje), tri subjekte kanë ushtruar nismën propozues të ligjeve. Për shembull, Këshilli i Ministrave është propozuesi kryesor në 100 raste, deputetët në 19 raste dhe kemi pasur një nismë ligjvënëse nga jo më pak se 20 mijë zgjedhës.

Nisur nga të dhënat statistikore dhe nga pikëpamja sasiore, mund themi se 44 amendamente nga 500, për projektligjet, këtë mund ta përmendim si pozitive, por kjo duhet parë natyrisht edhe në trajtë evolutive, janë propozuar nga grupet e interesit dhe nga shoqëria civile.

Gjithashtu, komisionet e përhershme kanë ushtruar kontrollin parlamentar për zbatimin e legjislationit. Kjo ka qenë një nga çështjet kryesore ku ne kemi mëshuar, sepse mendojmë se në këto vite nuk kemi vuajtur nga prodhimi i ligjeve, prodhimi i normave, por, në fakt, kemi një deficit në lidhje me kontrollin e zbatimit të ligjeve, me qëllim që ato të zbatohen me efikasitet. Ne si grup ekspertësh mendojmë që këtu Kuvendi ka një rol shumë të rëndësishëm. Megjithatë, gjatë vitit 2023, nëse e matim nga ana sasiore me seanca dëgjimore, vetëm për të ushtruar kontrollin parlamentar për zbatimin e ligjeve, janë zhvilluar 101 seanca dëgjimore.

Ne e konsiderojmë pozitiv faktin që Kuvendi operon edhe nëpërmjet platformës *online* për konsultimin publik të akteve ligjore. Pozitiv është edhe fakti që është rritur numri e organizatave të shoqërisë civile të regjistruara në regjistrin publik të OSHC-ve, pranë Kuvendit. Aktualisht kemi 78 organizata për vitin 2023, si dhe është krijuar regjistri për lobistët.

A ka probleme dhe sfida? Po, pa dyshim që ka një sërë problemesh. Ne disa prej këtyre problemeve i kemi evidentuar për t'i parashtruar para jush. Për shembull, kemi nevojë për përmirësimin e cilësisë së ligjbërjes. Në fazën e parë kishim nevojë për shumë ligje, sepse kishim mangësi ligjesh, kishim boshllëqe për shkak edhe të tranzicionit. Por mendimi ynë është se ne e kemi kaluar fazën e emergjencës, ndaj tani duhet t'i mësojmë cilësisë së ligjbërjes. Cilësia e ligjbërjes do punë, do procese dhe procedura. Pra, duhet të ulesh dhe t'i shkruash sa më qartë dhe me bazament, jo vetëm nenet e ligjit, por të gjitha dokumentet bashkëshoqëruese, sidomos duke përmirësuar relacionin bashkëshoqërues të projektligjit, duke arritur deri në atë fazë sa të kemi komentar për interpretimin origjinalist të ligjit; duke vijuar me dokumentet që na tregojnë përse është i domosdoshëm të miratohet ky ligj dhe me paketën e akteve nënligjore që ligji referon. Të paktën të kemi një projekt të kësaj pakete, të akteve që do të referohen nga ligji, duke vazhduar me shpenzimet buxhetore, me një përlllogaritje paraprake, duke vijuar me debate, diskutime, me afatet të arsyeshme dhe jo me afate të shpejta. Afatet e shpejta kanë mbetur nga koha e emergjencës, se ne vinim nga sistemi komunist dhe kishim mungesë të ligjeve në terren, sepse po ndërtonim një ekonomi të re, një demokraci me zhvillime të reja në të gjitha fushat. Unë mendoj se kjo fazë, edhe pse nuk ka kaluar tërësisht, nuk është më emergjente, prandaj kërkon që të maten më mirë, me qëllim që cilësia e ligjbërjes të rritet.

Pikën 2, që ju mund ta lexoni këtu, ne ia dedikojmë raportit tonë. Për shembull, kemi analiza të fragmentarizuara nga pikëpamja statistikore, nga pikëpamja sasiore, cilësore, pa u futur në problemet dhe shkaqet. Pra, një nga pikat më të dobëta që ne kemi evidentuar është roli i

Kuvendit në zbatimin e ligjit, me qëllim që ligjet të zbatohen me efikasitet. Kjo ka dalë qartazi, madje edhe në momentet kur Kuvendi, për një periudhë shumë të shkurtër kohe, nga miratimi një ligjit ka miratuar ose amendamente ose ligj të ri, normalisht kjo ka çuar në konkluzionin që duhet të forcohet roli i Kuvendit për zbatimin e tyre. Pra, ka mangësi në shqyrtimin postlegjislativ për të rritur efektivitetin e zbatimit të tyre.

Ka mangësi, për sa i përket vlerësimit parandalues në lidhje me korrupsionin, klientelizmat, nepotizmat në procesin legjislativ. Madje, kjo nuk është një temë shumë e zhvilluar, ndaj ka nevojë të zhvillohet, ka nevojë për analiza të theluara, ku të evidentohen shkaqet dhe problemet.

Edhe pse është një pikë e fortë përfshirja e shoqërisë civile në procesin legjislativ, pra ka procedura që ne kemi parë dhe mendojmë për një përfshirje më efektive, që duhet të përmirësohet, kjo kërkon edhe përmirësimin e punës së procedurave të Kuvendit, por edhe përmirësimin e punës nga shoqëria civile, sepse na duhen organizata të shoqërisë civile që kanë se çfarë të japin në këtë proces.

Rritjen e transparencës së komunikimeve me lobistët e regjistruar, e kemi shënuar si një aspekt evident të dukshëm.

Çështjet për zgjidhje në drejtimet kryesore të ndërhyrjeve.

Sikurse e thashë në fillim, janë vetëm aspektet themelore, sepse të gjitha këto pika duhet të analizohen konkretisht.

Për shembull, kemi vendosur përmirësimin e mekanizmave të kontrollit për zbatimin e ligjit, që lidhen me sfidat e problemet e evidentuara. Kemi vendosur përfshirjen efektive të shoqërisë civile në këtë proces, në përmirësimin e procedurave, rishikimin e afateve, transparencën në ushtrimin e funksionit ligjvënës në kuadër të masave parandaluese, klienteliste apo të atij që mund ta quajmë korrupsion legjislativ ose në procesin ligjvënës, sepse këto janë terma që po përdoren më shumë.

Cilësia e ligjvënies.

Te cilësia e ligjvënies kemi vendosur dy aspekte, por kjo nuk do të thotë që nuk do të shtohen edhe aspekte të tjera. Për shembull, një aspekt i rëndësishëm është: Kuvendi të ketë mekanizma të tillë që ta shikojnë papajtueshmërinë para se të shkojnë në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese nuk mund të shndërrohet në një dhomë të Kuvendit dhe në një organ që kontrollon papajtueshmërinë e ligjeve në çdo rast, por ajo duhet t'i zgjidhë vetëm konfliktet, kur ka konflikte të caktuara. Ndaj duhet të forcojmë mekanizmat e Kuvendit.

Kemi sugjeruar edhe mekanizmin për të parë dhe për të vjelë çfarë është e rëndësishme nga vetoja e ushtruar nga Presidenti i Republikës. Nga studimi që kemi bërë, mendojmë se Parlamenti ka nevojë të thellohet më shumë në gjetjet e vetos, me qëllim që të shohim se çfarë mund të përmirësojmë. Nuk po jap të dhëna sasiore të sakta, por kemi vënë re që disa nga vetot janë shndërruar në proces kushtetues, dhe Gjykata Kushtetuese ka pranuar kërkesën e Presidentit të Republikës në shumë raste. Ky është një minus për punën e Parlamentit, i cili duhet ta kishte evidentuar që gjatë ushtrimit të vetos problemin dhe nuk kishte pse të lejonte të kalojë procesi në Gjykatën Kushtetuese. Këto janë raste të veçanta, që pa dyshim që do të ketë të tilla, por mirë është që t'i kemi mekanizmat.

Nga pikëpamja e mjeteve, fillimisht kemi qëndruar te rishikimi i Rregullores së Kuvendit. Me lejoni të them dy fjalë për Rregulloren e Kuvendit.

Rregullorja e Kuvendit nuk është një vendim, siç e kemi sot. Jo, vendimi, po flas nga pikëpamja teoriko-juridike, është një akt politik. Rregullorja, do të thoni ju që është një akt politik, po është, por më shumë është akt normativ, kjo është e përcaktuar drejtpërdrejt nga Kushtetuta dhe nuk e ka emrin “vendim”, është rregullore. Çështja është që ne duhet ta ndryshojmë konceptin për Rregulloren e Kuvendit, sepse Rregullorja e Kuvendit ka një pozicion shumë të lartë në hierarkinë e normave dhe është rregullore e një organi përfaqësues. Teoritë tona në fushën kushtetuese minimumi mund ta zbresin deri në nivelin e ligjeve, ndërsa ka autorë që e konsiderojnë me fuqi poshtë Kushtetutës dhe mbi ligjet. Ndaj, në radhë të parë, ne duhet t'i japim karakter normativ. Pra, rishikimi i Rregullores së Kuvendit, duke përfshirë gjithë këto aspekte që i evidentova, vetëm në formën e fjalëve kyçe, le të themi, sepse dëshirojmë shumë që të marrim mendimin e të gjithë pjesëmarrësve të nderuar këtu, ka punë. Ne kemi vënë re shumë xhepa ku mund të ndërhyhet në Rregullore, madje mund të ketë një ripunim të përgjithshëm të saj, por në radhë parë duhet t'i jepet vendi që i takon. Ai vend i është rezervuar nga Kushtetuta dhe ne nuk kemi pse ta quajmë “vendim”, por do ta quajmë “Rregullore të Kuvendit”, akt normativ me fuqi normative që prodhon norma, (kjo është merita e saj që e bën edhe një rregullore akt normativ) dhe që ka fuqi, të paktën të barabartë me ligjim.

Po ashtu, mund të ketë edhe ligje të tjera, të cilat mund të lidhen me veprimtari të ndryshme në kuadër të kësaj pike që ne evidentuam, për marrëdhëniet institucionale të Kuvendit me institucionet e tjera, për të përmirësuar procesin ligjvënës, por Kushtetuta e brendshme e Kuvendit është Rregullorja, që është një akt i përgjithshëm normativ.

Kemi shumë teza për diskutim, që i kemi evidentuar. Disa prej tyre edhe mund të ndryshohen, por shqetësim ynë është që të rritet besimi i qytetarëve te Kuvendi dhe proceset ligjvënese. Në këtë kuadër një nga pikat kyçe që duam të diskutojmë është çështja e përmirësimit të transparencës në proces, e transparencës jo vetëm si qëllim në vetvete, po si qëllim për të thithur dhe për të rritur pjesëmarrjen në procesin ligjvënës nga jashtë Kuvendit, nga grupet e interesit, shtresat shoqërisë civile e tjera si këto.

Si mund të rritet efektiviteti i punës së Kuvendit, duke marrë në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit? Ne mund të parashtrojmë këtu: a kemi nevojë për një rishikim apo përcaktim më të mirë të funksioneve dhe kapaciteteve të strukturës administrative të Kuvendit për të rritur performancën në drejtim të zbatimit të ligjit? Pra, roli i Kuvendit është të kontrollojë se si po zbatohet një ligj që ka hyrë në fuqi. Pra, është një “fëmijë” i prodhuar nga Kuvendi dhe duhet të dijë se çfarë po ndodh me të, si po ecën dhe si po rritet. Ky është qëllimi.

A kemi nevojë për kapacitete në lidhje me kontrollin e pajtueshmërisë së normave me Kushtetutën? Ky nuk është qëllim në vetvete, që të mos shkojmë në Gjykatën Kushtetuese, por qëllimi është që të rrisim garancitë për ligje demokratike që respektojnë deri në fund të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës. Kjo është shumë e rëndësishme, forcimi i përfaqësimit të Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese, që të ketë seriozitetin e duhur, apo të diskutojmë mekanizmat që përdoren për të modernizuar punën e Kuvendit, me qëllim që qytetarët të afrohen sa më shumë dhe të informohen më mirë. Por, edhe në këtë rast kemi mjetet e teknologjisë.

Si është ndërveprimi mes ekzekutivit dhe legjislativit, në raport me kontrollin e projektligjeve apo amendamenteve që paraqiten, qoftë nga Këshilli i Ministrave, qoftë nga deputetët, qoftë nga qytetarët? Por, edhe komunikimi më pas me ta, se ligjpropozuesi mund të jetë edhe një grup interesi. Pra, a kemi komunikime më pas, apo thjesht sa e miratojmë, mbarojmë projektin dhe shkojmë?

Gjithashtu, kemi përmirësimin e konsultimit publik, pra përfshirjen e grupeve të interesit dhe OSHC-ve në zbatimin e projektligjeve, nëse duhet të kemi mekanizma për t'i riparë projektligjet, në mënyrë që rishikimi i projektligjeve të kalojë në disa mekanizma, siç mund të jenë organet e brendshme të Kuvendit.

Natyrisht që është në diskrecionin e pjesëmarrësve të tryezës të marrin shkas nga këto pyetje që janë ngritur, ose këto fjalë-kyçe që janë ngritur, apo të shtojnë të tjera për të diskutuar, duke pasur parasysh të gjitha gjetjet e prezantuara nga studimi ynë.

Faleminderit shumë për vëmendjen! Jemi këtu për të diskutuar dhe të them të drejtën po pres me padurim.

Faleminderit!

Juelda Lamçe – A ka pyetje apo komente për diskutim? Keni pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ju lutem, prezantohuni.

Erinda Ballanca – Unë jam Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Faleminderit shumë që ma dhatë fjalën!

Së pari, dua të shpreh edhe një herë falënderimin dhe mirënjohjen për profesoreshë Aurelën, për mënyrën e përmbledhur që i bëri këtij diskutimi, i cili ka qenë shumë i gjerë, sigurisht në tryeza të mëparshme. Sa herë që jam përballë zyshë Aurelës më duket vetja pak më e re. Domethënë më kujtohen ato kohë kur kam qenë në fakultet dhe shpresoj që të jem akoma në fakultet. Ky ishte një koment dashamirës.

Tek temat kryesore, që janë jashtëzakonisht shumë të rëndësishme për rritjen e nivelit të besimit të qytetarëve te Kuvendi dhe te procesi ligjbërës, shikoj një problem jo të vogël në Republikën e Shqipërisë. Fatkeqësisht, në këto vite besimi i publikut në të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë është më i ulët sesa në vendet e tjera të rajonit. Edhe tek Avokati i Popullit, *vis a vis* Avokatit të Popullit të Kosovës, për shembull, është më i ulët. Pra, ka një lloj mungese besimi të qytetarëve tek institucionet. Nga njëra anë ka arsye, por unë gjithmonë i shikoj problemet te vetja, për t'i përmirësuar, por një pjesë e perceptimit, në vlerësimin tim, vjen nga një debat politik tejet i ashpërsuar, i cili minon që në gjenezë çfarëdolloj iniciative për të çuar përpara, për të ngritur një problem, apo për t'i çuar gjërat përpara. Pra, në tezën që sollët për diskutim, se cilat mund të jenë çështjet për t'u zgjidhur gjatë procesit ligjbërës, mendoj se një nga çështjet që ne duhet të identifikojmë është konsensusi, si një mjet demokratik i politikës së mirë dhe i mirëqeverisjes, që është një element shumë i mirë për shoqërinë tonë.

Të paktën në 7-8 vjetët e fundit ka një retorikë, ku çdo konsensus i arritur politik për çështje ligjore apo edhe çdo zgjidhje e problematikave që ekzistojnë në shoqërinë tonë, anatemohehen si pazar, duke i dhënë që në fillim konotacion negativ dhe duke humbur besimin e qytetarëve. Pra, edhe nëse është një konsensus i mirë, i arritur për t'i çuar gjërat përpara, aty i vihet një emër negativ dhe pritshmëritë e besimi i qytetarëve bien menjëherë. Pra, nga kjo kulturë shumë e ashpër që ne kemi trashëguar, secili në llogoren e vet, asnjëherë nuk do të arrijmë një konsensus të përbashkët,

ndaj besoj që duhet bërë një punë shumë e madhe nga Kuvendi për të arritur një klimë normale politike. Këtu nuk ka rëndësi se cila prej forcave politike e ka për detyrë e para ta bëjë këtë gjë, sepse kjo është një çështje madhore kombëtare që ndikon drejtpërsëdrejti te qytetarët, te çdo lloj reforme, te çdo lloj institucioni, qoftë Kuvendi, qoftë gjykatat, qoftë Avokati i Popullit, qoftë shkollat, qoftë policia e të tjera. Pra, duhet të mundohemi të ndryshojmë pak mentalitetin, sepse minimi i besimit të publikut është realisht problematik.

Unë jam shumë e kënaqur kur shoh se për herë të parë ne guxojmë t'i themi Kuvendit duhet të shtoni kapacitetet. Unë kam vite që them se Kuvendi ka nevojë për kapacitete të shtuara, stafe të tëra për të bërë punën dhe kjo është shumë, shumë emergjente. Jo se personat që punojnë në Kuvend nuk janë të aftë që ta bëjnë punën e tyre, por numri i personave që janë në Kuvend për të bërë gjithë atë proces ligjvënës është i vogël dhe nuk arrijmë të kemi studime të plota, të thelluara dhe të mirëmbenduara. Pra, edhe deputetët duhet të kenë asistentë, duhet të kenë njerëz që punojnë për ta, në mënyrë që ata të jenë të fokusuar te ligjbërja.

Ndërkohë edhe Parlamenti i Republikës së Shqipërisë stafin mbështetës e ka shumë të vogël krahasimisht me atë që i nevojitet për të realizuar këto funksione të rëndësishme.

E di që populistët po shtojnë kapacitete për veten e tyre, por unë besoj se rezultati është më i rëndësishëm sesa kritikën që kemi ne në momentin e parë, pra do të ketë një cilësi më të mirë të punës dhe sigurisht që do të jetë një element pozitiv në të ardhmen. Nuk duhet të kemi frikë të kërkojmë ndihmë në ato raste kur nevojat për kapacitete janë të duhura.

Në lidhje me procesin e konsultimit publik të projektligjeve, edhe kjo çështje ka nevojë sigurisht për kapacitete, por ka nevojë, si e kam ndjerë unë, edhe për një këndvështrim të kundërt që bie ndesh herë pas here.

Kuvendi, që në një legjislaturë më parë, ka ndryshuar qasjen dhe është shumë më i hapur, pra në faqen e Kuvendit hidhen të gjitha aktet, projektligjet, ka transparencë e të tjerë, por mbetet aty. Pra, të gjitha institucioneve të tjera që duan të japin mendime për projektligjet, si shoqëria civile, Avokati i Popullit e të tjera Kuvendi u thotë që ne i kemi bërë, kjo është transparenca, ju mund të hyni t'i merrini dhe të sillni komentet. Por ka edhe raste kur Komisioni i Ligjeve në mënyrë të posaçme kërkon mendime për çështje të caktuara nga Avokati i Popullit apo të tjerë. Askush nuk ka kapacitete të pafundme, shoqëria civile jo e jo, që të rrijë dhe të kontrollojë çdo ditë faqen e Kuvendit. Pra, transparenca nuk është për të bërë një *tick*, që kam lënë aty dhe u bë transparenca, ndoshta duhet të kemi një mekanizëm që t'u jepet më shumë kohë (se as ne nuk kemi

kapacitete për të parë të gjithë ligjet apo amendamentet që bëhen për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut, do të donim shumë që ta bënim, por nuk i kemi të gjitha kapacitetet) dhe të jetë efektive. Pra, kjo transparencë që ne e kemi, për sa u përket projektligjeve dhe diskutimeve, duhet të bëhet efektive dhe të gjejmë një rrugë për të mënjeluar ato amendamentet e momentit të fundit, që herë pas here ndryshojnë në thelb kërkesën apo atë hullinë e parë ligjvënësë. Kjo do të krijonte një besim më të madh te shoqëria civile.

Ne kemi diskutuar herë pas here që shoqëria civile ndihet e dekurajuar, sepse nëse një anëtar i shoqërisë civile lodhet me kapacitetet e kufizuara, përpiket shumë për ta ushtruar këtë kompetencë, këtë të drejtë që ka dhe kur bën propozime për amendamente që nuk merren parasysh dhe nuk merr një përgjigje specifike përse nuk janë marrë parasysh, atëherë ai dekurajohet dhe nuk ka për ta bërë më këtë punë, pra dhënien e mendimeve, sepse askush nuk mund ta justifikojë veten që të bëjë një punë të papaguar, pasi shoqëria civile nuk ka fonde të posaçme për të bërë këtë gjë, pra të bëjë një punë të papaguar dhe të mos jetë efektive.

Kështu që, ndonjëherë, duke pasur këto kapacitete shtesë, mund të ketë pak më shumë kujdes, të ketë një koordinator që të flasë, të diskutojë, të adresojë, sepse, duke u ndjerë edhe ata më të adresuar, mund të ndihen se kanë qenë më efektivë në këtë proces. Kaq kisha.

Faleminderit!

Juelda Lamçe – Faleminderit!

Zonja Iris Luarasi.

Iris Luarasi – Faleminderit!

Unë jam Irisi nga Departamenti i Gazetarisë pranë Universitetit të Tiranës, që shikoj që është e shënuar edhe këtu. Në fakt, kam ardhur më shumë nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, sepse është një nga organizatat që ka sjellë një nismë në Parlament me firmat e 20 mijë zgjedhësve. Kështu që, për këtë arsye do ta fusja veten më tepër nën kapelën e Linjës së Këshillimit edhe si pjesë e shoqërisë civile.

Ne kemi provuar mbledhjen e firmave të votuesve për iniciimin e një nisme ligjore, që ishte krijimi i një regjistri kombëtar për autorët e krimeve seksuale. Ky ishte një *exercise* i vështirë, do të thosha, nuk ishte vetëm një nismë e Linjës së Këshillimit, por pati mbështetjen e 27 organizatave të tjera të shoqërisë civile në të gjithë vendin, që u përpoqën të mbledhin firma. Kjo ndodhi menjëherë pas pandemisë, që e bënte edhe më të vështirë ushtrimin, ndërkohë na mësoi edhe gjëra

të tjera për të kuptuar si funksiononte në realitet, kur do që të marrësh një iniciativë dhe do ta sjellësh atë në Parlament.

Kjo është një iniciativë, që tashmë është votuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe tregon se ishte një ushtrim, i cili në fund pati një sukses të konsiderueshëm. Një nga gjërat që ne mësuam, është se ishte shumë e vështirë të mbledhje 20 mijë firma qytetarësh për të ndryshuar një ligj, ndërkohë që duhen 10 mijë firma qytetarësh për të zgjedhur një deputet. Kjo gjë na mësoi që të bëjmë edhe disa krahasime me disa vende të tjera të zhvilluara në Europë. Mësuam që Italia, një vend që ka 68 milionë banorë, nismat e zgjedhësve i ka me 50 mijë votues. Kështu që, nuk mund të bëjmë krahasimin e 60 milionë banorëve me 50 mijë votues dhe 2 milionë e gjysmë apo 3 milionë banorëve me 20 mijë votues. Kjo ishte një nga gjërat që ne, në fakt, e kemi menduar që ta sjellim në Parlament, sepse, nëse do të donit të shikonit në Parlament nisma vërtet të qytetarëve dhe që i ndihmojnë grupet në rrezik, që u shërben shoqëria civile, mund të jetë një nga elementet që mund të merret në konsideratë dhe që do ta bënte edhe më të madh bashkëpunimin midis qytetarëve, shoqërisë civile, që në njëfarë mënyre është moderatori i komuniteteve, pastaj edhe politikës, që në këtë rast është Parlamenti. Ky ishte elementi i parë.

Elementi i dytë, tani nga një kapele tjetër: unë për tetë vjet kam qenë anëtare e Komitetit të GREVIO-s, komitet ekspertësh i Këshillit të Europës në Strasburg. Kjo më ka bërë që të monitoroj vende të tjera në Europë për implementimin e Konventës së Stambollit. Tani jam në ECRI dhe një javë më parë u ktheva nga vizita e monitorimit në Irlandë. Gjëja e parë që bëjnë organizatat ndërkombëtare monitoruese, është që shikojnë bashkëpunimin e politikës me shoqërinë civile. Në çdo takim monitorues që ditën e parë ne monitorojmë dhe i pyesim organizatat e shoqërisë civile për të marrë më shumë informacione dhe gjëja e parë ku punohet, natyrisht, është bashkëpunimi me Parlamentin dhe qeverinë. Patjetër, kjo të bën të kuptosh se ky është një rol super i rëndësishëm, sepse vërtet në një pjesë është pika ku ka lidhje me legjislacionin, por ky legjislacioni, në mënyrë që të implementohet, kalon shkallë-shkallë dhe detyrimisht vjen te shoqëria civile, vjen tek akademia për të përfutur nga ato që janë komunitetet në nevojë.

Në fakt, unë nuk do të thosha që ne e kemi pasur derën e Parlamentit të mbyllur, përkundrazi, sa herë ne kemi ndërmarrë nisma ligjore, sa herë ne kemi pasur ndryshime për të realizuar, siç ishte ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, që përsëri është një ligj i hartuar nga shoqëria civile, pavarësisht se ka qenë një iniciativë e deputetëve më parë, pasi ka qenë njëherë nisma e zonjës Bushka dhe e zonjës Gjermani, por ndër vite ka pësuar ndryshime,

me kërkesë të organizmave të shoqërisë civile, që tregon se mekanizmat funksionojnë dhe ne duhet të jemi aty për t'i rënë derës, që ajo dera të hapet.

Megjithatë, e dëgjova me vëmendje Erindën dhe mendoj se ka të drejtë, pasi patjetër që burimet njerëzore brenda shoqërisë civile janë të limituara. Fondet brenda sektorit, me të cilat këta persona punojnë, janë përsëri të limituara dhe do të ishte ndoshta shumë më mirë që për këto iniciativa, që kanë lidhje me grupe të caktuara të interesit, të njoftohen organizatat që janë pjesë e kësaj lloj fushe për legjislacionin e ri, në mënyrë që ata të jenë sa më të motivuar dhe të mos bëjnë këtë pjesën e *check in-it* të përditshëm për të parë pjesët që kanë lidhje me ligjet e reja që propozohen nga Kuvendi.

Faleminderit!

Juelda Lamçe – Faleminderit juve!

Po, zoti Beka, në mënyrë të përmbledhur, do t'ju lutesha.

Rinor Beka – Faleminderit!

Jam Rinor Beka nga Instituti Demokratik Amerikan.

Unë do të mundohem të ndaj me ju disa observime nga puna jonë shumëvjeçare me Parlamentin dhe disa gjetje specifike nga një studim që kishim vitin e kaluar për rolin e Parlamentit në adresimin e korrupsionit.

Shumë nga këto janë të përfshira tek analiza që ju keni ndarë me ne dhe, e para, ishte çështja e kohës. Shumë shpesh nuk ka kohë të mjaftueshme për deputetët, për shërbimet e Kuvendit dhe për aktorët e jashtëm, siç janë organizatat e shoqërisë civile, për të analizuar legjislacionin dhe për të dhënë kontributin për ta bërë një ligj më cilësor.

E dyta, në lidhje me analizën e riskut të korrupsionit, tek ai raport ne dolëm me disa propozime.

Së pari, duke marrë parasysh kapacitetet e kufizuara të Kuvendit, duhet që një draft fillestar të bëhet nga vetë ekzekutivi. Pra, ose nga ministritë e linjës, ose nga Ministria e Drejtësisë, ku të filtrohet ai draft dhe deputetëve t'u jepet një lloj deklarate, si *statement*, që ky draft është skanuar dhe nuk ka probleme apo elemente që mundësojnë korrupsionin.

Gjithashtu, ose duhet të bëhet një shërbim i veçantë tek administrata e Kuvendit, ose të forcohen kapacitetet e Shërbimit Juridik që, e para, të bëjë një formë verifikimi të analizës që vjen nga ekzekutivi; e dyta, të kenë mundësi të analizojnë amendamentet që bëhen gjatë procesit ligjbërës këtu.

E treta, duhet të ngrihen kapacitete edhe në nivel të grupeve parlamentare, që ato të skanojnë dhe të analizojnë projektligjet me vlerat e antikorruptionit, sepse në shumë vende ku ne po punojmë tani, shikojmë se incentivat për këtë çështje vijnë më shumë nga ana e opozitës. Nëse kjo bëhet siç duhet në Parlament dhe, nëse do të ketë kapacitete edhe nga jashtë, nga shoqëria civile dhe nga mediat investigative, atëherë do të rritet presioni edhe nga brenda, edhe nga jashtë dhe, nëse do të ketë probleme, besoj se ato do të adresohen më mirë.

Në lidhje me konsultimin, besoj se është bërë një punë shumë e mirë me platformën digjitale. Ajo që duhet bërë, ndoshta është një vlerësim për të parë se cili ka qenë impakti deri tani; sa qytetarë janë mobilizuar; sa amendamente kanë ardhur dhe çfarë mund të bëhet për të rritur efikasitetin.

E dyta, është çështja e seancave dëgjimore të komisionet. Natyrisht, individë apo grupe interesi vijnë me ftesa dhe ne kemi dëgjuar shumë raste që, ndoshta organizata të shoqërisë civile apo grupe interesi, nuk janë ftuar, ndaj duhet të ketë një mekanizëm ku të thonë që këta jemi ne dhe kemi interes për këtë projektligj, që duam të vijmë e të shprehim shqetësimet apo kërkesat tona.

Nga një projekt që kishim bashkë me kolegët e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe IDM-ja, kishim në fokus edhe punën me grupet e qytetarëve, të cilët donin ose të ndërmerrnin nisma direkt, ose të kontribuonin në projektligjet që ishin në procedurë. Nga puna që u bë me një grup fermerësh në atë kohë, erdhi një nismë ligjore, por ata kishin shumë nevojë për pjesën e ekspertizës, që atë draft ta bënin gati sipas kritereve që kërkon Kuvendi. Pashë edhe tek analiza që ju kishit evidentuar shumë mirë nevojën që administrata e Kuvendit të mund të mbështesë grupe qytetarësh, kur ata duan të vijnë me një nismë apo kur ata duan të bëjnë një ndryshim të ligjet që janë në procedurë.

Çështja e fundit që dua të ngre, ka të bëjë me transparencën legislative, ku, ndonëse është bërë një punë e mirë deri tani, ne si NDI në çdo vend që punojmë, promovojmë këtë që informacioni parlamentar i përket publikut. Prandaj, që nga koha kur vjen projektligji bashkë me të gjitha dokumentet shoqëruese, ditën që u shpërndahet deputetëve, është mirë që të vihet në dispozicion edhe të publikut. Më e rëndësishmja është që nga dita kur vjen në Parlament deri në ditën e miratimit çdo informacion apo çdo dokument, që përgatitet rreth atij projektligji, të jetë i qashtë për publikun, pra një dosje elektronike e projektligjit që do të mundësonte një transparencë më të madhe, ndoshta, një angazhim më të madh të të gjitha palëve të interesuara.

Faleminderit!

Juelda Lamçe – Faleminderit juve!

Po, fjala për ju.

Blerina Çeloaliaj – Faleminderit!

Jam Blerina Çeloaliaj dhe vij nga “*Save the Children*”.

Ju falënderoj realisht për këtë takim, si dhe për faktin që është takimi i dytë, të paktën për këtë javë, pasi dje ishim përsëri në këtë sallë, ku kishim një konsultim shumë të rëndësishëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ishte i gjashti për këtë javë?! Aq më mirë akoma.

Në fakt, në vijim të diskutimit që e nisi zonja Avokate e Popullit apo edhe zonja Luarasi lidhur me besimin e qytetarëve, unë do ta përktheja me fjalën: sa afër jemi ne përkundrejt qytetarëve ose sa pranë tyre jemi. Te qytetarët 1/3-ta janë fëmijë dhe të rinj. Një nga gjërat që unë kam vënë re dhe që ndoshta ka munguar, është një mekanizëm rutinë llogaridhënie, por edhe konsultimi.

E para, “*Save the Children*” ka pasur marrëdhënie të shkëlqyera me Parlamentin, sidomos me grupin e deputetëve “Miq të Fëmijëve”, që është tashmë rishtazi i zgjedhur, i vendosur dhe ka funksionuar, por kanë qenë konsultime *ad hoc* ose konsultime që janë kërkuar nga ne si organizata të shoqërisë civile dhe nuk kanë qenë të parashikuara në një kalendar rutinë nga ana e Kuvendit dhe nuk ka pasur një planifikim të temave, për të cilat do të konsultohemi.

E dyta, është shumë i drejtë fakti se shoqëria civile e njeh shumë mirë situatën në terren; njeh shumë mirë situatën e targetgrurit, me të cilin punon dhe, kur flasim si të rritim besimin e qytetarëve në përgjithësi, duhet të mendojmë pak më tej se si mund të rritim edhe besimin e anëtarëve që u përkasin grupeve më vulnerabël të shoqërisë. Pra, kur kemi sfida të qytetarëve në përgjithësi, duhet të mendojmë edhe se si të dublikohen dhe trefishohen këto sfida te grupet vulnerabël.

Gjëja që ndoshta ka munguar, është përkthimi në një gjuhë të kuptueshme të asaj për të cilën po konsultohemi. Pra, nuk mjafton, sikurse u tha dhe u përmend nga parafolësit, të hidhen ligjet *online* apo në platforma për konsultim, por ato duhet të shoqërohen me shpjegime. Nëse nuk janë kapacitetet në Kuvend në funksion të stafeve, atëherë të kërkohet ndihmë, ka një diskutim se kush i ka këto kapacitete dhe sesi mund të përkthehen, por kjo kërkon kohë. Pra, nuk kërkon afate urgjente, emergjente të konsultimeve, por kërkon pak kohë dhe planifikim.

Së treti, ajo që unë mendoj se është shumë e rëndësishme, ne kemi miratuar tashmë në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të të Drejtave të Fëmijëve, me vendim të ministrit, kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes për fëmijët dhe të rinjtë, dhe një nga standardet më të rëndësishme në këto kriteret është mekanizmi i *feedback*-ut. Pra, i konsultojmë fëmijët ose të rinjtë edhe për draftligje apo për projektligje. A vijmë mbrapsht te ky grup konsultimi me çfarë ndodhi, me *feedback*-un që morëm? Kjo do të rritë besimin, sepse, edhe nëse ai konsultim apo ai *feedback* nuk është përfshirë për një, dy ose tri arsye, ne kemi detyrimin të vijmë mbrapsht te grupet e konsultuara për të thënë arsyet pse nuk e morën parasysh *feedback*-un e tyre apo si u përkthye *feedback*-u i tyre në një, dy apo tri pika në projektligj apo në atë që në fund është marrë vendimi dhe është aprovuar në komisionet përkatëse.

Së fundi, dua të ritheksoj edhe një herë që konsultimet duhen bërë domethënëse, jo vetëm për hir të të bërit të konsultimit. Pra, nuk kemi thjesht një *checklist* që e plotësojmë, tani (dhe kjo është gjë e mirë që jemi këtu) ne diskutojmë për procese domethënëse konsultimi. Ne themi se kemi konsultuar fëmijët dhe të rinjtë, pa e kuptuar që ndonjëherë i kemi vendosur në risk nëpërmjet atij konsultimi që kemi bërë. Pra, të jetë një konsultim që ka një domethënie dhe është i përshtatshëm për grupmoshën, për targetgrupin dhe arsyen përse po ndodh. Prandaj, bëra lidhjen me faktin që dje ishim këtu dhe folëm për edukimin ligjor dhe mendoj se tema sot ka lidhje dhe me atë që diskutuam dje, sepse është shumë e rëndësishme që në fillimet e para, që në moshë të hershme, që në shkollë apo që në vijimësi të ketë një lloj prioritizimi të arsyes pse bëhen shumë gjëra. Pse ndodh edukimi ligjor i publikut? Si duhet të ndodhë? Pse ndodh në fëmijëri të hershme? Pse ndodh në shkollë? Si ua shpjegojmë ne fëmijëve dhe të rinjve se cilat janë rolet dhe potenciali që ata kanë për t'i shfrytëzuar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe në benefitin dypalësh, qoftë të tyre, qoftë edhe të Kuvendit?

Faleminderit!

Juelda Lamçe – Faleminderit juve!

Fjala për ministren Dhuka.

Majlinda Dhuka – Përshëndetje!

Unë jam Majlinda, ministre e Shtetit dhe Kryegoniciatore e Shqipërisë në negociatat me Bashkimin Europian.

Shumë faleminderit komisionit të posaçëm dhe grupit të ekspertëve për këtë vëmendje të veçantë dhe këtë energji të madhe profesionale, së pari, që po i japin nevojës për thellimin e

reformave në Shqipëri, në këtë çast historik dhe në të përafruarit e të qenit një vend anëtar i Bashkimit European! Është momenti më i rëndësishëm i profesionistëve dhe njerëzve tanë më të mirë nga shoqëria civile, nga Kuvendi, nga akademia e kështu me radhë. Kështu që, ju faleminderit shumë nga zemra!

Unë desha të sillja në vëmendje disa çështje, për ta vendosur diskutimin edhe në një këndvështrim ose prespektivë jo vetëm të brendshme, por edhe të rrugëtimit drejt anëtarësimit në Bashkimin European, sepse mendoj se kemi nevojë që ta thellojmë vetëdijesimin për momentin ku jemi dhe ku do të shkojmë.

Sjell në vëmendjen tuaj edhe një herë se Komisioni European ka bërë publike mbështetjen e ambicies për mbylljen e të gjithë kapitujve të negociatave me Shqipërinë brenda vitit 2027. Kjo do të thotë se në tre vjetët që vijnë aktiviteti ligjbërës do të jetë më shumë intensiv në kuptimin e të realizuarit të nismave në një kohë më të shkurtër sesa në tre vjetët që po lëmë pas. Kështu që, përmirësimet e procesit ligjbërës janë në momentin më të përshtatshëm për të krijuar edhe një shtrat të favorshëm për intensifikimin e aktivitetit ligjbërës teksa ne përafrojmë kuadrin ligjor european dhe standardin european në tre vjetët që do të vijnë. Sigurisht, më tej aktiviteti do të vazhdojë, por këto janë vite intensive për të mbyllur hendekun e përafrimit në fushat ku kemi ende hendek.

Kështu që, do t'ju lutesha të vetëdijesohemi në lidhje me këtë moment kaq të veçantë dhe intensifikimin e aktivitetit ligjbërës. Gjithashtu, përmirësimet e procesit ligjbërës duhet të mirëpresin këtë intensifikim dhe t'i shërbejnë këtij përsheptimi.

Së dyti, dua të sjell në vëmendje se edhe procesi ligjbërës me t'u bërë anëtar në Bashkimin European do të ndryshojë. Po ju sjell thjesht një shembull nga një vend anëtar në Europën Veriore, ku rreth 80% e aktivitetit të Kuvendit është e ndikuar drejtpërdrejt nga legjislacioni i Bashkimit European. Pra, të bërit anëtar do të thotë se disa çështje, në kuptimin rregullativ, kalojnë në juridiksionin european, pra disa çështje, disa fusha, pasi disa të tjera janë në juridiksionin kombëtar, dhe ne duhet të përgatitemi për këtë ndryshim, që është po ashtu shumë i rëndësishëm.

Nga ana tjetër, një pjesë e aktivitetit ligjbërës ndryshon dhe në një drejtim tjetër. Sot ne ende përafrojmë rregulloret e Bashkimit European, duke i bërë shpesh pjesë të ligjeve tona, përveçse të akteve ligjore. Me t'u bërë vend anëtar, rregulloret janë të vetëzbatueshme. Ne duhet të bëjmë një *revert proces*, pra një proces të kthimit pas dhe mendoj se procesi ligjbërës dhe procesi administrativ, që e mbështet atë, duhet të përgatitet me një aftësi për të rishikuar rastet kur kemi

përafruar rregullore, ndryshime të cilat do t'i kthejmë pas, sepse do të bëhen të vetëzbatueshme rregulloret e Bashkimit European.

Pra, duhet të kuptojmë që procesi ligjbërës është në një pikë të udhëtimit të tij, ku priten të ndodhin ndryshime të rëndësishme, dhe unë do të rekomandoja që në diskutimet e grupit të përfshihen këto dimensione. Pra, jo vetëm të shohim nevojat e brendshme, që janë shumë të rëndësishme dhe të respektueshme, por dhe bashkëjetesën që do të krijojë sistemi ynë legjislativ me një sistem të ri legjislativ, procesi ligjbërës european me procesin ligjbërës kombëtar, ashtu sikurse edhe institucionet europiane, përfshirë gjykatat, të cilat do të fitojnë juridiksion edhe në territorin e Republikës së Shqipërisë, sidomos për sa u përket të ashtuquajturave *infringement procedure*.

Këtu dal te pika e fundit, që doja të sillja në vëmendje, që ka të bëjë me zbatimin e ligjit. Ne do ta përfundojmë procesin e përafrimit dhe më pas do të harmonizohemi me ritmin përafrues të çdo vendi anëtar, pra do t'i mbyllim hendeqet dhe më pas do të sillemi si çdo vend anëtar. Sfidë do të jetë më e madhe në lidhje me zbatimin, sepse zbatimi nuk do të mbikëqyret vetëm nga Kuvendi i Shqipërisë, por Republika e Shqipërisë ka angazhime të zbatimit të legjislacionit european edhe përballë Bashkimit European, si një vend anëtar. Në këtë kuptim, i gjithë *scrutiny* postlegjislativ duhet t'i shërbejë edhe angazhimit european, me qëllim që të evidentohen rastet e *infringement* ose të shkeljes së traktatit, të cilat ndeshen dhe në vendet anëtare të Bashkimit European, sidomos në vendet anëtare të reja.

Kështu që, në këtë kuptim, me mirëkuptimin tuaj, profesoreshtë, unë do ta ftoja grupin e ekspertëve të hapeshin drejt idesë së një prespektive shumë të afërt dhe të përmirësimit që duhet të pësoj procesi ligjbërës në mirëpritjen e kësaj prespektive.

Faleminderit shumë!

Edhe unë i bashkohem asaj që tha Erinda, pasi jam po ashtu një ish-studentja juaj, jemi prej nesh që drejtojmë institucionet e vendit dhe përpiqemi të sjellim progres.

Faleminderit shumë, profesoreshtë!

Juelda Lamçe – Shumë faleminderit!

A ka komente të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithsesi, do të jetë edhe një prezantim i dytë. Ndoshta një pjesë e pyetjeve mund të rezervohen dhe për pjesën e dytë të prezantimit, pasi të dyja prezantimet janë të ndërlidhura.

Po, profesoreshtë.

Aurela Anastasi – Përpara se të fillojmë prezantimin e dytë, unë do të doja shumë të falënderoja të gjithë parafolësit këtu, kolegët, ish-studentët e të tjerë. Vërtet trajtuat çështje shumë të rëndësishme, disa prej të cilave ne i kemi trajtuar, i kemi ngritur si shqetësime dhe vërtet shikojmë se ka nevojë të qasemi në aspekte nga më të ndryshmet.

Përgjithësisht, e gjithë vëmendja ka qenë që ky proces të përmirësohet në kuadrin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe ne, më shumë sesa të përshpejtojmë ligjet që duhet të miratojmë në kuadrin e përmbylljes së negociatave, duhet njëkohësisht edhe të paraqesim një proces me dinjitet, për mendimin tim.

Nuk e di se sa mund të përplasen këto me njëra-tjetrën, sepse nga të gjitha drejtimet, edhe nga ekspertë, edhe nga kolegë, vijnë kërkesa që të përmirësojnë procesin në kuadër të përfshirjes së mendimeve dhe rritjes së besimit nga ana e publikut. Kjo kërkon përmirësimin e teknikave, kërkon rritjen e kapaciteteve brenda Kuvendit, përmirësimin e konsultimeve, rritjen e transparencës. Këtu u kërkua edhe zgjatja e kohës, pasi nuk ka kohë për të bërë konsultime. Ne natyrisht në raportin tonë thamë se duhen rishikuar afatet për amendamentet kushtetuese, absolutisht është më se e drejtë. Por, natyrisht, qasja që sollën të gjitha diskutimet këtu, si vlerësimi i riskut, që është një element krejt i ri, sidomos vlerësimi i riskut që ka të bëjë me parandalimin e korrupsionit, këto të gjitha duan kohë.

Pra, nga njëra anë, ne kërkojmë kohë dhe rritje të kapaciteteve administrative dhe forcim të procesit ligjvënës, nga ana tjetër, duhet të përshpejtohem për procesin e integritetit, siç, me të drejtë, e përmendi këtu zonja Majlinda.

Ne duhet të gjejmë një të mesme, në këtë kuadër, sepse, që kemi nevojë për disa përmirësime, absolutisht, kjo është më se e vërtetë. Për shembull, nuk po trajtoj kërkesën që u bë këtu për kohë, por nëse ne kemi amendamente brenda në seancë e pas gjysmë ore ato kalojnë pa u shqyrtuar fare, vetëm se duhet të kalojë ligji, miratimi në parim, miratimi nen për nen, miratimi në tërësi, të gjitha këto bashkë, e të mbyllen të gjitha aty, mua nuk më duket e arsyeshme. Duhet ta gjejmë kohën dhe ta përmirësojmë procesin, sepse integriteti ynë në Bashkimin Europian kërkon edhe përshpejtimin e mbylljen e xhëpave dhe boshllëqeve, është më se e vërtetë, por kemi edhe kaq vite që po përafrojmë, në këtë kuadër shpresoj që të kemi ecur, por edhe në përmirësimin e cilësisë së ligjvënës.

Unë këtë merak kisha dhe absolutisht që do t'i marrim në konsideratë ato që u trajtuan këtu.

Juelda Lamçe – Faleminderit, profesoreshtë!

Siç e thashë, ne do të kemi një prezantim të dytë, kështu që do të jetë mundësia për të bërë komente në vijim dhe, mbi të gjitha, pyetje për këtë pikë, por edhe për atë që do të prezantojmë tani.

Nënfusha e grupit që kemi trajtuar bashkërisht me kolegët Dedja dhe Marku lidhet, pikërisht, me efektivitetin, transparencën dhe llogaridhënien e vetë Kuvendit.

Sigurisht, këtu sot një pjesën e diskutimeve u paraprinë nga profesoreshtë Aurela dhe në gjetjet dhe në diskutimet që ne kemi trajtuar së bashku me arritjet dhe me problematikat që do të duhet të shtrohen në këtë tryezë, një pjesë e tyre janë tashmë të ezauruara në pjesën e parë. Megjithatë, shkurtimisht po i përmbahem prezantimit që kemi përgatitur, duke paraqitur pjesën hyrëse, pra edhe metodologjinë, shumë shkurt pjesën e progresit dhe të arritjeve, do të ndalemi në mënyrë më të zgjeruar te gjetjet dhe problematikat, konkluzionet dhe çështjet për zgjidhjet dhe drejtimet e ndërhyrjeve, që do të vijojnë më pas, dhe tezat për diskutim publik.

Nga pikëpamja e kontekstit dhe pjesa hyrëse, sigurisht, rëndësia që ka vetë Kuvendi është më se domethënëse në rolin e demokracisë. Nga pikëpamja e metodologjisë, janë trajtuar dhe janë analizuar një sërë dokumentesh të vëna në dispozicion, që lidhen me raportet vendase dhe të ndërkombëtareve dhe, sigurisht, e gjithë analiza është bërë me një vëmendje të thelluar ndaj nevojave të qytetarëve.

Nëse do të ndalemi te roli dhe funksionet e Kuvendit, analiza, sigurisht, është gjithëpërfshirëse dhe do të trajtojë jo vetëm funksionin ligjvënës, por edhe mbikëqyrjen apo kontrollin ndaj ekzekutivit, mbikëqyrjen ndaj institucioneve të pavarura dhe rolin në integrimin europian, për të cilin falënderoj posaçërisht ministren Dhuka, e cila e bëri mjaft të qartë momentin më se të përshtatshëm për të diskutuar për këtë çështje.

Pa diskutim, çështjet këtu janë pa fund dhe ne jemi fokusuar në një analizë të problematikave më të rëndësishme, duke u ndaluar te performanca e strukturave administrative dhe politike të Kuvendit, për të parë, gjithashtu, mekanizmat e transparencës për të zgjedhurit, pra integritetin, deklarimin e pasurisë, konfliktin e interesit. Po kështu, jemi ndalur tek transparenca e veprimtarisë së Kuvendit në drejtim të aktorëve të shoqërisë civile, në drejtim të publikut dhe të palëve të tjera të interesuara. Kemi parë mekanizmat ndërveprues të Kuvendit me aktorët e shoqërisë civile, me median dhe publikun, transparencën në menaxhimin e fondeve të Kuvendit, si dhe fondeve të donatorëve, gjë për të cilën do t'ju flasë pak më vonë kolegu Frroku, si dhe

aksesin e shpejtë, transparencën në dokumentacionin parlamentarm e analizuar kryesisht nga kolegia e shoqërisë civile.

Lidhur me progresin dhe arritjet, ne kemi dashur ta përmbledhim në një fjali të vetme, po themi, pozicionin e Kuvendit në këtë proces, duke thënë se anketa “Besimi në qeverisje” e 2023-shit e Institutit Demokratik Kombëtar, konkludon: Parlamenti është një ndër tre mekanizmat, së bashku me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe medien, perceptuar si më efektivët për llogaridhënien. Kjo nuk do të thotë se nuk ka ende punë për të bërë, përkundrazi, gjetjet dhe rekomandimet janë të shumta tek të gjitha pikat për të cilat ne diskutuam derti tani.

Në mënyrë të përmbledhur progresi dhe arritjet janë fokusuar pikërisht te roli që ka Kuvendi në procesin e integritetit evropian. Fakti që kemi ndryshime ligjore të vitit 2023, me ligjin nr.19, i cili ndryshon ligjin e mëparshëm nr.15/2015, është pikërisht një ndër arritjet kryesore, e evidentuar edhe nga raportet e ndërkombëtarëve. Pa dyshim që ka pasur rritje të përfaqësimit të shoqërisë civile në veprimtarinë parlamentare, ka ende shumë punë për të bërë, pa diskutim, ka një përmirësim të nivelit të transparencës përkundrejt shoqërisë civile, publikut dhe palëve të tjera (fakti që kemi miratimin e Kodit Etik për deputetët dhe udhëzimet përkatëse konsiderohet si një arritje), përmirësimi i menaxhimit, pra transparenca në kuptimin e menaxhimit të fondeve, ashtu sikundër edhe përdorimi i teknologjisë dhe i digjitalizimit, që është një sfidë për të gjithë. Sigurisht, ne do të fokusohemi për të parë rekomandimet e mëtejshme.

Në lidhje me problematikat dhe sfidat, jemi përpjekur të bëjmë një ndarje sipas nënfushave që kemi prekur secili, por, për të bërë një përmbledhje të sfidave, mund të themi që retorika e ashpër parlamentare dhe sjelljet joetike u evidentuan edhe sot në këtë takim, si një problematikë për t’u zgjidhur, që duhet adresuar. Gjithashtu, u diskutua nevoja për një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe ndërgjegjësim të lartë, siç janë konsultimet në kohë, veçanërisht në lidhje me nismat ligjvënëse të Kuvendit, por edhe intensifikimi i mbikëqyrjes parlamentare në lidhje me performancën e ekzekutivit. Kjo ndoshta është pika ku raportet e ndërkombëtarëve, progresraporti i vitit 2024, ashtu sikundër në të njëjtën linjë edhe raportprogresi i vitit 2023, vënë theksin te mbikëqyrja e Kuvendit ndaj ekzekutivit, e cila duhet t’i përdorë të gjitha mekanizmat me efektivitet, në kohë dhe me transparençë, në mënyrë që të arrijmë rezultatet e kërkuara.

Po kështu, intensifikimi i mbikëqyrjes së institucioneve të varësisë, të agjencive ekzekutive dhe zbatimi i rekomandimeve të institucioneve të pavarura kanë qenë pikat më të trajtuara në raportet që ne kemi analizuar, duke pasur parasysh që një pjesë e mirë e rekomandimeve të

Avokatit të Popullit nuk kanë gjetur zbatim apo zbatim efektiv në kohë. Ky është momenti për të reflektuar, sepse janë pikat ku ne duhet të ndalemi dhe t'i thellojmë në mënyrë specifike problematikat dhe sfidat e mbikëqyrjes të institucioneve të pavarura, sikundër përmenda çështjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, por ka edhe pengesa në kryerjen me efektivitet të veprimtarisë për çështjen e burimeve njerëzore, pra ka nevoja për një mbështetje në kuptimin e burimeve njerëzore, e njëjta gjë vlen edhe për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Janë evidentuar problematika në raport me përzgjedhjen e anëtarëve në KLGJ dhe KLP, duke pasur parasysh edhe vonesat në emërimet e tyre, gjë që duhet mbajtur në konsideratë në veprimtarinë e Kuvendit në të ardhmen, si dhe sa i përket verifikimit të pastërtisë së figurës dhe pasurisë, në raport me meritokracinë dhe transparencën e procesit.

Është vënë në dukje rëndësia që ka përzgjedhja e këtyre kandidatëve jomagjistratë, duke plotësuar të njëjtat kritere, pra që këta kandidatë të kenë të njëjtat kritere me ata që janë magjistratë, në kuptimin e verifikimit të pastërtisë së figurës, të meritokracisë dhe të gjitha kritereve që duhen përmbushur për përzgjedhjen e tyre.

Fakti që kemi një numër të lartë të vakancave të magjistratëve inspektorë, është një problematikë që detajohet në draftaportin tonë, të depozituar tashmë pranë komisionit. Janë evidentuar problematika me pavarësinë e autoritetit rregullativ të mediave audiovizive, kjo për shkak të formulës dy partiake për zgjedhjen e anëtarëve të bordit dhe përkatësisë së tyre politike, pavarësia e transmetuesit publik, gjithashtu, është evidentuar si çështje që duhet adresuar, si dhe ekzistenca e një game të gjerë përjashtimesh apo mangësish në zbatim të ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Një pikë më vetë janë problematikat dhe sfidat, që lidhen me zbatimin e programeve të standardeve të transparencës së ndërveprimit të Kuvendit me publikun dhe shoqërinë civile dhe palët e treta. Kolegia nga shoqëria civile ka evidentuar gjetjet specifike dhe do të jetë e gatshme për t'u dhënë përgjigje pyetjeve tuaja, nëse do të keni. Në mënyrë të përmbledhur, gjetjet kryesore lidhen me publikimin e dokumentacionit parlamentar, në veçanti procesverbalet e seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve, që duhet të jenë më në kohë dhe më miqësore për përdoruesit. Ne këtu e trajtuam si çështje, si tematikë, pra informacioni është, janë ndërmarrë hapat dhe është bërë progres në termat e transparencës, por mund të bëhet edhe më mirë, gjuha mund të jetë edhe më e thjeshtë dhe më e kuptueshme për publikun. Respektimi i afateve, sigurisht, që do ta përmirësonte ndjeshëm dhe dukshëm procesin.

Në lidhje me përmirësimin e mekanizmave aktualë, siç janë regjistri *online*, platforma *online* e konsultimit të projektligjeve, pa diskutim, ka pasur përmirësim, por mund të shikojmë detaje të tjera se si mund ta përmirësojmë më tej, madje këto ishin disa prej pyetjeve që u hodhën për diskutim publik në këtë tryezë; përditësimi në faqen e internetit i të dhënave për deputetët, të cilat, në fakt, i kemi, por informacioni për ta mund të përmirësohet, duke shtuar më shumë informacion dhe duke e përditësuar vazhdimisht, siç janë çështjet që lidhen me historikun e vendimmarrjes me partinë që përfaqëson, ligjet për të cilat ka votuar, si dhe deklarimin financiar.

Një pikë specifike është çështja e transkriptimeve, që do ta ndihmonte shumë procesin, do ta bënte shumë më transparent, më të shpejtë në kohë, do t'i ndihmonte të gjitha palët për të ndërvepruar, që është dhe qëllimi, mes të gjitha palëve, pra bashkëpunimi mes të gjitha palëve; rritja e kapaciteteve të administratës në institucionin e Kuvendit është një çështje që ne e diskutuam dhe u ndalëm gjerësisht.

Për ta përmbyllur, problematikat që lidhen me menaxhimin e fondeve të Kuvendit, gjithëpërfshirja në buxhetimin e institucionit është një nga gjetjet kryesore, që adresohet për zgjidhje; rritja e transparencës në monitorimin dhe argumentimin e zbatimit të buxhetit; transparencë e plotë në publikimin e dokumenteve të menaxhimit financiar, për të cilat ndoshta do të kemi mundësi të ndalemi pak më vonë; sigurimi i informacionit të detajuar dhe të aksesueshëm për publikun; rritje e transparencës përmes digjitalizimit të shumë proceseve të veprimtarisë parlamentare, përtej atyre që janë realizuar tashmë; dhe krijimi i platformave që lehtësojnë përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrjen e ligjeve.

Çështjet që adresojmë për zgjidhje, të ndërlidhura me ato që sapo diskutuam, janë: rritja e kapaciteteve të komisioneve parlamentare. Në fakt, ne e kemi diskutuar brenda grupit tonë, që mund të hamendësohet ose të vlerësohet propozimi për rritjen e numrit të komisioneve të përhershme parlamentare, duke i ndarë ato në më shumë grupe dhe me më pak anëtarë, kjo jo vetëm me nevojat që ka aktualisht Kuvendi, por edhe me një qasje krahasimore me vendet e tjera.

Po ndalem te pjesa e parë. A do ta rriste, dhe kjo është në formën e një teze për diskutim, efektivitetin e veprimtarisë së Kuvendit nëndarja e grupeve të komisioneve të përhershme në më shumë nëngrupe, duke pasur parasysh edhe heterogjenitetin e disa çështjeve që trajtohen, por edhe duke pasur parasysh vizionin për të ardhmen? Ka shumë vende të Bashkimit European që po adresojnë çështjen e digjitalizimit të teknologjisë, ndoshta një komision i përhershëm, i cili

rigrupohet edhe një herë me ato grupe që ekzistojnë tashmë, mund të ishte një alternativë, por presim mendimin tuaj për këtë çështje.

Adresojmë për zgjidhje çështjen e forcimit të mekanizmave të mbikëqyrjes së Kuvendit për zbatimin e ligjeve që miraton, por edhe kjo u diskutua, ashtu sikundër edhe reflektimi mbi *postscrutiny*, për vlerësimin *expos* të ligjeve, për të parë zbatueshmërinë dhe efektivitetin e tyre.

Transkriptimin e përmendëm, ndaj nuk po ndalem më shumë.

Përforcimi i sistemit të llogaridhënies për deputetët ndaj qytetarëve, ishte një nga nënpikat që ne trajtuam gjerësisht. Aktualisht ka një nivel transparence, që është vlerësuar si i tillë në raportet e ndërkombëtarëve, por mendoj se mund të bëhet edhe më transparent.

Do të ishte i nevojshëm trajnimi i stafit të Kuvendit. Trajnimi i stafit të Kuvendit është përmendur në raportet vendase dhe ndërkombëtare si një pikë e fortë e Kuvendit, sepse janë zhvilluar trajnime dhe kanë ardhur gjithmonë në përmirësim e sipër, por ne këtu do të ndalemi tek trajnimi në mënyrë të posaçme për çështjen e transkriptimeve, sepse kjo do ta bënte edhe më efikase.

Kjo ishte pjesa e fundit e prezantimit tek tezat për diskutim publik.

Ne kemi renditur të parën çështjen e komisioneve të përhershme parlamentare, nëse do të mund të rritej efektiviteti i punës së Kuvendit, duke rritur numrin e këtyre komisioneve. Kemi shtruar për debat çështjen e përmirësimit të efektivitetit në raport me digjitalizimin. Për të gjitha çështjet që trajtuam si në pjesën e parë, ashtu edhe në pjesën e dytë, jemi të hapur të marrin jo vetëm komentet tuaja, por edhe pyetje, meqë nuk patëm në pjesën e parë.

Ju falënderoj!

Fjala për ju.

Esmeralda Hoxha – Përsëritet, unë jam Esmeralda Hoxha, nga qendra “Aleanca gjinore për zhvillim”.

Jam shumë e nderuar që jam sot këtu. Pavarësisht asaj që u tha, personalisht në punën time shumëvjeçare tashmë në shoqërinë civile për monitorimin e pushtetit vendor apo edhe atij qendror në fusha të ndryshme, unë e shikoj Parlamentin si një prej institucioneve më të hapura, më transparente, me gjithë problematikat që ka.

Nëse flasim për Komisionin e Ligjeve, jo pak herë ne marrim ftesa, por ka raste që nuk marrim ftesa për të dhënë rekomandimet tona. Siç u përmend edhe nga kolegët tanë pak më parë, qoftë nga Avokatja i Popullit apo organizatat e shoqërisë civile këtu, edhe nga ministrja, zonja

Dhuka, jemi duke folur për qytetarët, sepse organizatat e shoqërisë civile kanë marrë përsipër të advokojnë, të llobojnë, të monitorojnë, të nxjerrin problematika, të bashkëpunojnë. Sa shkon informacioni, qoftë ky edhe për integrimin në BE, edhe për implementimin e këtyre ligjeve, sipas standardeve të BE-së, te qytetarët? Qytetarët dinë vetëm një fjalë: “Do bëhemi pjesë e BE-së e do të punojmë ku të duam”, nëse jemi duke folur për ato grupe qytetarësh, të cilët kanë mungesa në informacion, mungesa në arsimim, pra nuk e kanë informacionin. Sot flasim për digjitalizim, dhe shumë mirë bëjmë, flasim për inteligjencën artificiale sot, dhe shumë mirë bëjmë, po për ato grupe qytetarësh, qofshin të mbijetuarat e dhunës në familje, qofshin gra që punojnë në sektorin e fasonerive, në fabrikat e prodhimit të veshjeve dhe këpucëve, po ato gra që jetojnë në zona rurale, të cilat nuk kanë absolutisht akses në internet, dhe kjo për një mijë arsye, nuk kanë akses në telefona të zgjuar?

Për t’iu rikthyer edhe një herë edhe asaj që u tha këtu pak më parë, si shoqëri civile do të donim të kishte më shumë kohë për rekomandimet dhe opinionet që kërkohen nga ne për disa iniciativa që merr Kuvendi i Shqipërisë. Ju i keni në databazë, i përmendi edhe pak më parë profesoreshë Aurela, që janë rreth mbi 70 organizata të shoqërisë civile dhe do të ishte shumë mirë që informacionin, kërkesat t’i marrim dhe të kemi kohën e duhur.

Ne duam të jemi pjesë e çdo komisioni që organizohet, e çdo dëgjese, duam të bëhemi pjesë e çdo rekomandimi, sidomos në fushat ku ne punojmë, pa u ndarë, sepse në përgjithësi organizatat e shoqërisë civile janë të fokusuar në fusha specifike, ku japin edhe opinionet e tyre.

Për t’u rikthyer edhe një herë, nëse flasim për programe transparence, nëse flasim për hapjen e Parlamentit sa më shumë, duhet të kemi parasysh se çfarë mekanizmash duhet të përdoren qoftë nga ju, qoftë nga ne, si shoqëri civile, për t’i ardhur në ndihmë qytetarit, sepse në fund të ditës jemi duke folur për qytetarët, që ata ta ketë informacionin e duhur, ta kenë mundësinë të jenë pjesë e vendimmarrjeve.

Nëse krahasojmë Parlamentin me pushtetin vendor, jemi këtu. Prej vitesh tanimë ne monitorojmë pushtetin vendor në së paku 10 + 2 bashki të vendit, njësi të qeverisjes vendore, se sa transparentë janë ata kundrejt qytetarëve, kundrejt votuesve, sa i angazhojnë qytetarët në nivel vendor, sipas ligjit “Për konsultimin publik”. Jo pak herë kemi dalë me rekomandime, jo pak herë jemi ulur me kryetarë, nënkryetarë apo edhe staf tjetër të pushtetit vendor, të bashkive, dhe, fatmirësisht, kemi një bashkëpunim shumë të mirë sesi duhen angazhuar qytetarët.

Aktualisht jemi duke analizuar, pikërisht, zbatimin e ligjit të konsultimit publik në pushtetin vendor, nuk dua të zgjatem se nuk është ky sot momenti, por kemi parë që ka shumë mungesa. Prandaj, mendoj se Parlamenti i Shqipërisë jep një shembull mjaft të mirë, i cili duhet ndjekur, me të gjitha problematikat që ju keni nxjerrë, shumë prej tyre i kisha bërë si pyetje, por ju i keni nxjerrë dhe kolegët i analizuan pak më përpara, ndaj nuk do të ndalem më shumë.

Shumë faleminderit për kohën dhe mundësinë!

Juelda Lamçe – Faleminderit juve!

Fjala për komisionerin.

Besnik Dervishi - Përshëndetje!

Unë jam Besnik Dervishi, Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Do përpiqem të mos flas kaq gjatë sa është emërtimi i institucionit.

Falënderoj të gjithë parafolësit, veçanërisht grupin e ekspertëve, sepse, në fund të fundit, janë prekur disa problematika, të cilat unë personalisht, për shkak të eksperiencës, qoftë në trupën e deputetëve, qoftë tashmë prej dhjetë vjetësh në drejtimin e një institucioni të pavarur, kam vënë re që janë shqetësim prej vitesh si të Kuvendit, por veçanërisht të institucioneve të pavarura!

Do të doja të falënderoja veçanërisht ndërhyrjen e Avokates së Popullit dhe të Kryenegociatores, sepse përmendën disa gjëra që unë nuk do t'i përsëris, por që lidhen me çështje që mendoj se ndihmojnë si procesin ligjvënës, ashtu edhe marrëdhëniet me Parlamentin, veçanërisht institucionet e pavarura në veçanti.

A duhet të forcohet Parlamenti? Patjetër që duhet të forcohet. Unë do t'ju jap një shembull, që lidhet me atë që përmendi Kryenegociatorja: ne kemi një ligj tejte të rëndësishëm, që është transpozimi i rregullatorit, GDPR-it, që është një nga dy ligjet organike mbi të cilat funksionon Zyra e Komisionerit, është një proces që ka filluar në vitin 2020 dhe sot më në fund kemi arritur të vijmë në Komisionin e Ligjeve, ku natyrisht na pret një punë shumë e vështirë besoj, dhe këtu e paralajmëroj kryetaren, që do të kemi një punë jo të lehtë në diskutimin e tij. Përse?

Unë do të prek një aspekt, që ndoshta mund të duket provokues në këtë pikë. Është një ligj shumë specifik, që për nga detajet është i vështirë të zbatohet edhe nga Franca, edhe nga Gjermania, por edhe nga shtete të tjera shumë të zhvilluara europiane, për rrjedhojë ka vështirësi më të shtuar te ne. Mungon një ekspertizë e thelluar për sa i përket *data protection* në Shqipëri, nuk ka ekspertë të mirëfilltë të *data protection*, ose ka shumë pak të tillë. Ka kaluar disa herë për mendime në të gjitha institucionet, natyrisht, është zhvilluar një proces model i konsultimit publik

me të gjitha grupet e interesit, por ne kemi pasur një vështirësi tejet të madhe me institucionet, veçanërisht me institucionet në varësi të ekzekutivit, për shkak të problematikave që paraqet kjo çështje, për të thënë që arrihet deri në cenim të pavarësisë së institucionit nga disa skema konservatore, të vjetra, veçanërisht financiare, kur GDPR-i është shumë i qartë në nenin 52: institucioni i Komisionerit mund të auditohet për aq kohë sa nuk cenohet pavarësia e tij, domethënë shkon deri në këtë pikë, kurse ne kërkojmë që strukturën ta miratojë Ministria e Financave, të shkojë për mendim të DAP-i, të ndërhyjë... Pra, janë disa gjëra që nuk shkojnë, dhe kjo duhet parë në procesin ligjvënës, si duhet zgjidhur kjo që të dal tek tema e këtij takimi.

Do të ishte mirë që këto kapacitete t'i kishte Kuvendi dhe ligjet tejet specifike ta kishin procesin kryesisht në Kuvend, pra të krijohet ajo lidhja, marrëdhënia. Mbase është e vështirë të kenë propozim institucionet e pavarura, sepse kjo kërkon një ndërhyrje Kushtetuese, dhe nuk e di, mbase profesoreshë Aurela mund të më ndihmojë, në qoftë se ka dhe vende të tjera ku ka iniciativë ligjvënëse edhe nga institucionet e pavarura, të paktën me sa di unë nuk ka, por ndoshta mund të krijohet një lidhje e drejtpërdrejtë me Kuvendin, ku të mos cenohet pavarësia e institucioneve të pavarura në këtë pikë. Në këtë mënyrë ruhet integriteti i Kuvendit, ruhet integriteti i Këshillit të Ministrave, por edhe integriteti i institucioneve të pavarura.

Kjo është një problematikë që mund të gjejë një zgjidhje dhe insistoj fort në forcimin e kapaciteteve të Kuvendit, sepse, përveçse është detyra e Kuvendit, është edhe pjesa, ku institucionet e pavarura duhet të gjejnë mbështetjen e tyre. Natyrisht, monitorimi në këtë pikë bëhet në mënyrë më profesionale.

Para disa vitesh, për ata të cilët janë punonjës të vjetër të Kuvendit, e kujtojnë që ka pasur një projekt binjakëzimi me parlamentin italian, unë isha i ftuar në një seancë, ku, për hir të vërtetës, mbeta edhe pak i surprizuar nga ekspertët e huaj të parlamentit italian, më duket se ishin edhe ekspertë të parlamentit grek, nëse nuk gaboj, sepse pyetjet e tyre ishin shumë të thjeshta: “Cili është mendimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit për seancat që zhvillojnë komisionet e përhershme parlamentare dhe të gjitha komisionet e tjera në Kuvend? A duhet të jenë të hapura, duhet të transmetohen drejtpërdrejt? A duhen të transkriptohen dhe t'i vihen në pozicion publikut, apo duhet të kufizohen?” Unë thashë se, pavarësisht se opinionimi ynë nuk është gati, qoftë edhe Parlamenti nuk është gati, ne do të bëjmë ç'është e mundur që ato të jenë të hapura, të transmetohen drejtpërdrejt dhe të vihen në dispozicion të publikut. E vlerësoj, është bërë një punë shumë e mirë, programi i transparencës së Kuvendit, dhe më vjen mirë që përmendet dhe nga shoqëria civile, ne

bëjmë një monitorim të tyre dhe një publikim të indeksit të transparencës së autoriteteve publike, është shumë mirë, ku ka një koordinator, që funksionon shumë mirë, ka njësi të monitorimit të institucioneve të pavarura, që, në këndvështrimin tonë modest, funksionon shumë mirë për sa u përket problematikave. A ka ende për të bërë me transparencën? Patjetër që ka ende shumë për të bërë, dhe janë të gjitha këto diskutimet që po zhvillojmë bashku, ama mund të shërbejnë edhe si model.

Unë e përmenda edhe dje në një takim tjetër, programi i transparencës është një instrument që na jep ligji, me të cilin ne mund të shkojmë shumë thellë dhe nuk ka nevojë të shpikim ligje të tjera, sepse i kemi, ndaj të thellohem dhe të perfeksionojmë.

Së fundi, kjo që do të them nuk është për polemika, absolutisht, ne do të ishim të interesuar ta kishim opinionin, sepse ne çdo fundvit zhvillojmë një tryezë me shoqërinë civile për të thithur mendimet e tyre në raport me dy fushat e të drejtave të njeriut që mbulon Zyra e Komisionerit, veçanërisht për të drejtën për informim, ku ka një gamë të gjerë përjashtimesh dhe mangësish në zbatim të ligjit “Për të drejtën e informimit”, po në çdo rast është neni 17 i ligjit, i cili parashikon kufizimet.

Kjo është një temë që ne e kemi diskutuar shumë shpesh, por ne nisemi, uroj edhe ekspertët, në çdo rast, të jenë nisur nga testi i interesit publik, sepse nga vetë testi i interesit publik bëhet edhe balanca. Ne u referohemi vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që sugjerojnë bërjen e testit të interesit publik në çdo rast, si dhe shqyrtimin rast pas rasti dhe në mënyrë proporcionale. Ky është përkufizimi.

Ligji “Për të drejtën e informimit”, me thënë të drejtën, është në një nga pesë ligjet më të mira në botë, kështu klasifikohet. Ne kemi pasur shumë vështirësi dhe në amendimet që u bënë vitin e kaluar, këtu falënderoj Kuvendin, në këtë rast, për mbështetjen në këtë drejtim, hapësirat janë shumë të ngushta. Megjithatë, ne jemi shumë të prirur për të dëgjuar çdo sugjerim, Kuvendi është vendi më i mirë për t’i reflektuar ato sa më shpejt, sepse e kuptojmë çdo ditë se ligji “Për të drejtën e informimit”, transparenca, bëhet gjithmonë e rëndësishme në çdo proces, pra në çdo tryezë, në çdo proces transparenca është një nga elementet kryesore.

Faleminderit dhe ju kërkoj ndjesë nëse u zgjata njëlloj si emri i vetë institucionit!

Juelda Lamçe – Faleminderit!

Po.

Elvin Gjevori – Përshëndetje!

Shkurtimisht, pasi shumica e gjërave u thanë.

Desha të lidhja atë që thanë profesoreshat për sa i përket ligjvënies me cilësi dhe mbikëqyrjes efektive. Kur flasim për Kuvendin, pavarësisht se është një institucion, janë dy shina këtu brenda: janë deputetët, pjesa politike, është edhe administrata, që krijon mjedisin mundësues.

Për sa i përket të parës, duhet të ketë vullnet politik, duhet të ketë dëshirë të brendshme, që ligji të jetë i mirë dhe që mbikëqyrja të jetë efektive, dhe kjo është pjesa politike, është pjesa e deputetëve.

Sa i përket të dytës, është administrata ajo që krijon mjedisin mundësues për deputetët që kanë dëshirë t'i bëjnë këto të dyja, që të kenë të dhënat, faktet, analizat dhe informacionet.

Në çdo vend të botës ka një disbalancë të madhe midis informacionit që ka ekzekutivi dhe informacionit që ka legjislativi. Qeveria ka gjithmonë më shumë informacion se deputetët, sepse është në zbatim, ka të dhënat, ka agjencitë e varësisë, që japin të dhënat, ndërkohë që Kuvendi është pak më në disavantazh.

Ish-kolegët e mi, dhe këtu janë drejtoreshat, bëjnë një punë shumë të mirë për sa i përket analizës ligjore, pra përputhjes me Kushtetutën, me aktet e tjera ligjore e kështu me radhë. Kjo analizë bëhet gjithmonë dhe bëhet shumë e plotë.

Ajo që ka filluar të bëhet, dhe duhet bërë më mirë, është analiza përmbajtësore e shumë ligjeve që vijnë këtu dhe analizat krahasimore që kërkohen nga deputetët.

Edhe nga eksperiencia ime, shumica e deputetëve kërkojnë të dinë si e bëjnë vende të tjera të njëjtën gjë që ka ardhur si propozim nga qeveria. Si është bërë më parë? Pse është ndryshuar dhe cilat janë shkaqet? Të gjitha këto bëhen në njësinë “kohë” dhe, pavarësisht se ne jemi përpjekur ta bëjmë mirë dhe shpejt, “mirë” dhe “shpejt” në shumicën e rasteve nuk përputhen, janë kontradiktore.

Kështu që, përveç vullnetit politik, që është diçka që shkon përtej pjesës teknike që po diskutojmë, pjesa teknike, që është në shërbim dhe në mbështetje të vullnetit politik, ka nevojë për më shumë kohë dhe disa instrumente që e lejojnë ta bëjnë punën më mirë, që të mos vijnë ligjet aq shpejt, të jetë më e parashikueshme puna që ato duhet të bëjnë, në mënyrë që edhe burimet njerëzore të kenë mundësinë të bëjnë të gjitha ato analiza që duhen në lidhje me atë që ju thatë.

Faleminderit!

Juelda Lamçe – Faleminderit, zoti Gjevori!

Migena Kondo – Përhëndetje!

Unë jam Migena Kondo, eksperte ligjore e pavarur, njëkohësisht edhe eksperte për kontrollin postlegjislativ, në kuadër të programit britanik, nëpërmjet fondacionit “*Westminster Foundation for Democracy*”.

Edhe për mua është një kënaqësi shumë e veçantë që të dëgjoj profesoreshë Aurelën, si ish-studente e saj!

Do të fokusohem më shumë te kontrolli postlegjislativ dhe progresi që ka bërë Kuvendi, në kuadër të projektit për sa i takon pilotimit të disa ligjeve, pilotimit të metodologjisë të kontrollit postlegjislativ (metodologji e hartuar dhe e përshtatur me rregulloren dhe procedurat e brendshme të Kuvendit, në bazë të manualit për PLS-në, të hartuar nga Parlamenti dhe “*Westminster Foundation for Democracy*”), si dhe të gjitha ato gjetjet që janë bërë në kuadër të vlerësimit bazë nëse Kuvendi ka mandat, ka metodologji, ka procedura të brendshme dhe staf të dedikuar dhe të specializuar për të realizuar kontrollin postlegjislativ dhe për të mbështetur komisionet. Mandatin e kanë komisionet e përhershme, për ta bërë kontrollin postlegjislativ, që është neni 18 në kuadër të mbikëqyrjes. A ka specializim, a ka struktura të dedikuara? Këto janë gjetjet kryesore, që ka bërë edhe vlerësimi bazë dhe në bazë të tij është bërë edhe metodologjia e përshtatur dhe hapat që duhet të ndiqen, në mënyrë që ky proces të brendësohet brenda Kuvendit.

Në kuadër të kësaj metodologjie, është hartuar edhe një propozim për atë që quhet “Gjurmues legjislativ”, pra në momentin që një komision, i cili është edhe organi që ka kompetencën dhe mandatin për të bërë kontrollin postlegjislativ, të ketë një *database*, ku të ketë ligje të cilat miratohen, ligje të cilat kanë disa kriter në këtë *database* dhe, nëpërmjet një alerti, të bëjë një ndjekje të vazhdueshme të ligjeve të miratuara për të kontrolluar zbatueshmërinë e tyre, qoftë sa u takon akteve nënligjore, institucioneve, mekanizmave, qoftë dhe sa i takon impaktit apo ndikimit që ky ligj ka synuar paraprakisht.

Kontrolli postlegjislativ ka dy dimensionë: dimensionin e parë është për të përmirësuar cilësinë e ligjeve, ndërsa dimensionin e dytë është për të kontrolluar veprimtarinë e ekzekutivit dhe për të shmangur ndryshimet e shpeshta, që i bëhen legjislacionit. Është një proces që i mundëson Kuvendit të jetë pjesë e ciklit legjislativ, pra të mos mbarojë puna e Kuvendit në momentin e miratimit të ligjit, por të jetë një monitorues i vazhdueshëm.

E gjithë paketa *ex ante*, pra të gjitha vlerësimet që vijnë përpara miratimit janë një bazë kryesore në vlerësimin që i bëhet më pas *ex post* zbatimit, domethënë shikohet dhe testohet

vlerësimi *ex ante*, se sa kanë qenë të vërteta dhe të drejta këto supozime në vlerësimet *ex ante* dhe sa janë vërtetuar në zbatimin e ligjit.

Doja të thosha edhe 2-3 gjëra për sa i përket konsultimit publik brenda Kuvendit.

Juelda Lamçe – Të lutem, shumë shkurt, sepse jemi në limitet e kohës dhe kemi edhe dy-tre persona të tjerë që duan të flasin.

Migena Kondo – Është një proces, i cili është jo vetëm pjesë e miratimit të ligjeve e procesit *ex ante*, por edhe e PLS-së. Kontrolli postlegjislativ një nga komponentët kryesorë të tij ka gjithëpërfshirjen, pra konsultimi i kontrollit postlegjislativ është një element i rëndësishëm i këtij procesi.

I gjithë konsultimi që bëhet paraprakisht është një benefit që institucionet, Kuvendi në këtë rast duhet ta thithin nga aktorët dhe nga palët e interesit, jo domosdoshmërisht vetëm nga organizatat e shoqërisë civile, por të bëhet një hartëzim i të gjitha palëve që kanë interes në një ligj të caktuar.

Dy problematikat që unë personalisht i identifikoj sa i takon konsultimit publik, veçanërisht në Kuvend, janë njoftimet në kohë, pra jo vetëm duhet të nisen herët, por edhe të njoftohen herët. Duke qenë se konsultimi në Kuvend është një proces diskrecional, palët e interesit nuk mund ta dinë paraprakisht nëse do të ketë një vendimmarrje për konsultim ose jo, pra momenti i vendimmarrjes për konsultime duhet të jetë më i hershëm, në mënyrë që palët të kenë mundësinë të përgatiten për të sjellë kontributet e tyre.

Konsultimi me shkrim, që është një metodë që duhet të jetë gjithmonë në konsultim, nuk është specifikisht i parashikuar në nenin 36, por vetëm dëgjuesat publike, duke pasur parasysh që një dëgjese publike është një nga mekanizmat e konsultimit, ndërsa konsultimi me shkrim, i cili mundësohet nga platforma *online*, duhet të jetë më i elaboruar dhe më i qartë në rregullore, si një proces që duhet të jetë aty gjatë gjithë kohës, pavarësisht nëse palët mund të vijnë në dëgjese ose jo.

Faleminderit!

Juelda Lamçe – Faleminderit!

Zotëria pas e ka fjalën.

Agim Rrapaj – Faleminderit!

Jam Agim Rrapaj, nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar.

Sa më shumë që po dëgjoj këto fjalime, aq më shumë po bindem për rëndësinë e këtij komisioni, aq më shumë zgjat dhe interesi ynë për dobinë e këtij komisioni. Doja ta theksoja këtë, pasi sa më shumë që dëgjoj, aq më shumë shtohet interesi.

E dëgjova profesoreshë Aurelën dhe ekspertin tjetër dhe realisht bindem se fjalët kyçe janë po ato. Në qoftë se ato fjalë kyçe shkojnë deri poshtë për t'u zbatuar, do të kenë shumë dobi për ne. Foli për dobinë e kontrollit të zbatimit të legjislacionit. Për këtë do t'ju sjell një shembull. Në vitin 2012 kam qenë i pranishëm në ligjin nr. 38/2012, që është bërë për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, që kërkohej për MSA-të. Na u tha se duhej të bëhej shpejt e të tjera, u bë shpejt, u bë një gjysmë ligji, por nga viti 2012 e deri më sot, u tha se do të ketë edhe akte nënligjore. Nuk ka asnjë akt nënligjor, as e ka kontrolluar njeri dhe as nuk është marrë asgjë parasysh për këtë ligj. Ka plot shembuj të kësaj natyre.

Disa nga ligjet janë shumë të rëndësishme për ne, janë shumë të rëndësishme për t'u *update*-uar, por edhe për t'u riformuluar, siç e tha edhe zonja Dhuka, në kuadër të integritetit. Ne kemi propozuar që në vitin 2015 për ta ndryshuar këtë ligj, por askush nuk na dëgjon. Në fakt, ky ligj është shumë i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me kooperimin që është një plagë për të gjithë sektorin, është gati 72% i pakoooperuar, 28% dhe ne pa një ligj nuk mund ta realizojmë këtë. E kanë kot që përpiqen dhe thonë me artifica.

Njëkohësisht, edhe koha e bërjes së ligjit ka shumë rëndësi, pavarësisht nga ngarkesa që do të ketë. Me këto drejtori juridike që unë kam parë, të paktën në institucionet që ne kemi, me ngarkesën operative që ato kanë dhe me ngarkesat që ato marrin nuk u shkon mendja për t'u marrë me këtë proces që është kaq i rëndësishëm. Për këtë arsye ju them që ky komision është mjaft i rëndësishëm, sepse është si truri elektronik i të gjithë procesit për ta realizuar atë. Për ne si biznes është shumë e rëndësishme, veçanërisht për zonat rurale, që disa nga ligjet të konsultohen në mënyrë eficiente, sepse shpeshherë konsultimi shkon si një proces rutinë duke e nxjerrë në faqen e ministrisë; për mendimin tim mirë bëjnë që e nxjerrin në faqe, por shumë prej ekspertëve tanë nuk e kanë mundësinë për ta realizuar, por edhe kapacitetet tona nuk janë të atilla që ne, si shoqëri civile, ta përballojmë ngarkesën që kemi. Unë mendoj se ky komision do të ketë një avantazh për ne në të ardhmen për të realizuar disa nga ato objektiva që ne mendojmë se duhen realizuar.

Faleminderit!

Juelda Lamçe – Faleminderit, juve!

Në fakt, siç e kisha imagjinuar, koha në dispozicion është e pakët për të trajtuar të gjitha çështjet që kemi këtu.

Po ia jap fjalën kolegut tim, doktorit të shkencave, Mariel Frroku, i cili ka qenë pjesë e grupit të punës.

Mariel Frroku – Faleminderit!

Unë jam Mariel Frroku, përfaqësues i Universitetit të Tiranës. Më duket se jam i vetmi që kam pasur fatin e keq të mos jem student i zyshës, meqë jam ekonomist, por besoj se ka qenë vlerë te grupi, sepse ne kemi parë edhe një këndvështrim tjetër të Kuvendit, që është këndvështrimi i menaxhimit financiar. Patjetër, të gjitha këto që diskutuam janë të rëndësishme, janë të rëndësishme që ne t'i bëjmë bashkë. Një ndër vlerësimet kryesore që kemi parë te raporti është edhe çështja e menaxhimit financiar dhe kapaciteteve. Jemi fiks në momentin e duhur, edhe për faktin që buxheti i vitit 2025 po diskutohet nëpër komisione, dhe kemi gjykuar se pavarësisht të gjithë procesit që kalon menaxhimi financiar i Kuvendit si të gjitha institucionet e tjera, ndoshta për shkak se është brenda shtëpisë së vet, trajtohet i gjithë buxheti i shtetit, duhet forcuar diskutimi që të rriten kapacitetet e burimeve njerëzore dhe mbështetja buxhetore për Kuvendin, në mënyrë të atillë që këto kapacitete të ngrihen. Ne vërtet kemi folur për digjitalizimin, vërtet kemi folur për strukturat mbështetëse të komisioneve, vërtet i kemi diskutuar të gjitha këto, por ndoshta është momenti i duhur që të marrim një hap konkret përpara lidhur me forcimin e këtyre kapaciteteve përmes diskutimit të menaxhimit financiar.

Normalisht, një element tjetër që është i rëndësishëm, të paktën për jetën parlamentare, dhe që ne e kemi gjykuar në këndvështrimin tonë si menaxherë financiarë, është i lidhur me ndryshueshmërinë ose destabilitetin që krijohet nga ndryshueshmëria shpeshherë e atij që ne vendosin si target për ta realizuar nga menaxhimi financiar, që do të thotë sa më e qëndrueshme të jetë kjo, sa më mirë ne të planifikojmë, sa më mirë ne ta dimë se çfarë do të ndodhë 3 vjetët e ardhshëm, aq më mirë do t'i ndihmojmë edhe kapacitetet e brendshme të Kuvendit që të administrojnë më mirë, të ndërtojnë struktura më të mira dhe patjetër, të jenë më efektive.

Kjo ishte një ndërhyrje për ta potencuar këtë proces, sepse mendojmë vërtet se tani është momenti dhe të gjitha këto që ne diskutuam, duhet t'i shtrojmë që të japin zgjidhje nga viti 2025 e prapa.

Faleminderit!

Juelda Lamçe – Faleminderit!

Fjala për zotin Gjipali.

Gledis Gjipali – Faleminderit!

Do të flas shumë shkurt.

Unë jam Gledis Gjipali nga Lëvizja Europiane në Shqipëri.

Procesi i konsultimit, që u përmend edhe në të dyja prezantimet, është shumë i rëndësishëm si proces, element që u trajtua edhe nga parafolësit. Do të doja të tërhiqja vëmendjen sa i takon aspektit të ndarjes së rolit të administratës, pra çfarë bëhet në proces konsultimi nga administrata, përfshirë këtu edhe platformën e konsultimit. Do të thosha se në nivel të ekzekutivit funksionon, pra trajtohen të gjitha ligjet. E njëjta gjë besoj se duhet të ndodhë edhe në Kuvend dhe kjo është e rëndësishme.

Gjithashtu, duke u nisur nga procesi i integritetit, i cili do të jetë mjaft intensiv, sidomos gjatë 3 vjetëve të ardhshëm, po ta parashikojmë, do të jenë disa qindra ligje që do të kalojnë gjatë këtyre 3 vjetëve, pra është një proces i cili do ta vështirësojë akoma më shumë procesin e konsultimit apo të thithjes së ekspertizës. Për këtë arsye mendoj se duhet të parashikohet një mekanizëm, qoftë edhe i përkohshëm gjatë procesit të negociatave, për të adresuar të gjithë procesin ligjvënës, e lidhur kjo edhe me gjurmueshmërinë e procesit, të rekomandimeve si trajtohen dhe si rrëzohen ato, sepse lidhet po ashtu edhe me tryezën e djeshme që u bë në lidhje me integritetin dhe me vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në legjislacion; të gjitha këto janë elemente të lidhura me njëra-tjetrën. Në fakt, Shqipëria nuk ka pasur problemet që kanë pasur vende të tjera apo që i kanë shprehur kolegët tanë të Ballkanit sa i takon legjislacionit të kaluar me shpejtësi për shkak të procesit të integritetit europian, gjë që sjell mangësi në konsultim dhe në transparencë. Ky problem është i theksuar sidomos në vende si Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Ne nuk e kemi pasur, por besoj se shumë shpejt do ta kemi, nëse për 3 vjet do të na duhet të përfundojmë të gjithë kapitujt e negociatave; do të jetë një korpus i madh legjislativ që do të kalojë, qoftë edhe ato ligje që janë në një përputhshmëri të madhe, përsëri do të duhet të kalojnë për një përputhshmëri të plotë. Kjo duhet pasur parasysh në adresimin tashmë për një periudhë afatshkurtër, sepse nuk bëhet fjalë për afatmesëm apo afatgjatë.

Faleminderit!

Juelda Lamçe – Faleminderit juve!

Fjalën e ka zoti Gjonçaj.

Genci Gjonçaj – Faleminderit!

Edhe unë do të flas shumë shkurtimisht.

Unë jam Genci Gjonçaj, sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë. Është shumë mirë që unë së bashku me ekipin tim ju dëgjojmë, pasi është një mundësi shumë e mirë që edhe ne t'i shohim gjërat në një këndvështrim tjetër, sepse një sy i jashtëm është shumë herë më mirë se si mund t'i zhvillojmë për t'i përmirësuar gjërat.

Shkurtimisht, më vjen mirë që në gjetjet e prezantuar, natyrisht ju i referoheni vitit 2023, profesoreshë, por shumë nga gjërat që ju keni gjetur kanë filluar dhe kanë gjetur zbatim, po flas këtu për *post-legislative scrutiny* dhe *anti-corruption proofing*, janë gjëra që morën nga viti 2023 kohën për të përgatitur kapacitetet dhe ngritur stafet dhe tani janë gjëra që po ndodhin. Se si mund të bëhet më mirë, pa dyshim që kjo ka nevojë për një ndërhyrje në Rregulloren e Kuvendit. Pse? Sepse duhen përcaktuar si procese pune, të cilat duhet të bëhen të detyrueshme për çdo projektligj, i cili depozitohet në Kuvend.

E njëjta gjë vlen edhe për transparencën. E thënë thjesht fare, Kuvendi mund të jetë institucioni, jo pse është pjesë e punës sime, më transparent në Shqipëri dhe për arsye të transparencës konkurren me parlamente të Bashkimit Europian. Këtu i referohem qasjes dhe afrimit të informacionit që i shkon publikut. Ne kemi zgjedhur të operojmë dhe të shkojmë direkt te qytetari nëpërmjet transmetimit të të gjitha mbledhjeve të komisioneve në mënyrë të pavarur nga media dhe për të përcjellë atje informacionin që i duhet qytetarit për gjërat që diskutohen në Kuvend. Nuk është Kuvendi, nuk janë komisionet vende vetëm të batutave politike, por janë vende ku diskutohen ligje, të cilat kanë një rëndësi për jetën e qytetarit, prandaj ne kemi vendosur të shkojmë direkt tek ai. Tani që jemi duke folur të tetë komisionet mund të jenë *online* 24 në 24 dhe me një qasje që kushdo që ka nevojë për një informacion mund ta marrë thjesht dhe vetëm nga faqja jonë e Kuvendit.

Janë dy gjëra, të cilat unë i konsideroj shumë të rëndësishme dhe këtu shoh Shqipërinë 2030.

E para, sa i takon ligjbërjes ne duhet të krijojmë një sistem, për të cilin ne po punojmë prej dy vjetësh, që quhet ILO. Parlamenti punon me sistemin *e-parlament*, Këshilli i Ministrave, si propozuesi kryesor i ligjeve në Parlament, po punon me sistemin *e-gov*, Presidenca ende nuk ka një sistem të vetin dhe Qendra e Botimeve Zyrtare ka një. Ne duam t'i bëjmë këto 3 apo 4 institucione, të cilët janë pjesë e procesit ligjbërës, të flasin me një gjuhë, jo vetëm me një gjuhë teknike, por edhe me një gjuhë të unifikuar që prezanton standardet e Bashkimit Europian. Një gjë

e tillë ndodh në parlamentet e Bashkimit European. Ne e kemi filluar në Parlamentin tonë dhe besoj se jemi në rrugën e mbarë. Kjo duhet të jetë një ndër shtyllat kryesore jo vetëm për faktin që krijojmë një sistem të unifikuar të ligjbërjes, meqë çështja kryesore është procesi i ligjbërjes në Kuvend, por edhe për faktin e aksesit më të thjeshtë që do të kenë qytetarët dhe kushdo që ka një interes për të kuptuar se si ka ecur një ligj që nga momenti i hartimit dhe i draftimit, që nga momenti i diskutimit në Këshillin e Ministrave, diskutimet që kanë ndodhur në Kuvend, apo nëse ka pasur diskutim nga Presidenti i Republikës në formën e kthimit të aktit përsëri. Kjo është njëra çështje.

Çështja e dytë besoj se është Parlamenti që i duhet vendit tonë për 2030-en, është një ligj organik i organizimit dhe funksionimit të Parlamentit. Ju, profesoreshë me shumë të drejtë morët në referencë Rregulloren, dhe është ashtu siç e thoni ju, Rregullorja, është akti më i rëndësishëm dhe nuk konkurren dot, sipas mendimit tim, si jurist, por këtu po e lë në diskrecion të mendimit edhe të kolegëve që janë juristë, është akt që vjen direkt pas Kushtetutës për sa i përket fuqisë juridike. Pse? Sepse Kushtetua e ka autorizuar në mënyrë eksplicite organizimin dhe funksionimin e Kuvendit. Por ajo që do t'i duhet Parlamentit dhe është prezente në të gjitha vendet e Bashkimit European është ligji i organizimit dhe funksionimit të Parlamentit në vetvete. Çfarë siguron kjo gjë? Siguron dy shtylla të rëndësishme.

U ngacmova pak edhe nga biseda e kolegut lidhur me financat. Ne jemi një Parlament që miratojmë buxhetin e shtetit dhe nuk miratojmë dot buxhetin tonë. Të gjithë anëtarët e institucioneve të pavarura që janë këtu i dinë shumë mirë diskutimet që bëhen në komisione lidhur mbi numrat, me kapacitetet dhe me financat e tyre.

Pavarësia financiare dhe administrative e Kuvendit është një çelës për t'i dhënë rolin që Parlamenti ka në një republikë parlamentare, dhe në Republikën tonë parlamentare, Parlamenti është institucioni më i rëndësishëm. Prandaj kjo gjë e shtuar, së bashku me mënyrën e trajtimit të deputetëve, duhet të marrë formën e një ligji kuadër që, përveçse është detyrim kushtetues që një institucion si Parlamenti të ketë ligjin e tij organik, të ketë edhe rregulla të përcaktuara ku Parlamenti ta ushtrojë funksionin e tij kushtetues si institucioni më i rëndësishëm i vendit.

Thashë, është *non sens*. Unë do të jem pas pak ditësh në të njëjtën pozitë me Besnikun, me Erindën dhe me të gjithë, do të jem para Komisionit të Ekonomisë, natyrisht, duke miratuar në Byronë e Kuvendit kërkesat dhe nevojat, por përsëri do t'i nënshtrohem të njëjtës filozofi ku numrat nuk preken, buxhetet janë të limituara e për rrjedhojë kjo na vendos në vështirësi.

Parlamenti ka nevojë për struktura fleksibël në aspektin administrativ, ku të sigurojë konsulencë të vazhdueshme, të qëndrueshme, edhe sipas nevojës, sepse kjo është shumë e rëndësishme, pra ekspertizën që do t'i duhet vërtet Parlamentit për çështje të caktuara që dalin përtej njohurive që ka stafi ekzistues ose që do të vijë nesër, apo numra dhe funksione të shtuara herë pas here.

Unë nuk besoj se u zgjata. Uroj të mos më shajë përkthyesi në këtë pikë!

Faleminderit!

Juelda Lamçe – Faleminderit juve!

Fjala për profesoreshë Aurelën. Ndoshta keni ndonjë pyetje?

Aurela Anastasi – Faleminderit që ma dhatë fjalën mua në përfundim!

Natyrisht, unë nuk kam qëllim të bëj një përmbledhje të përgjithshme, sepse këtu u evidentuan një sërë problemesh, por doja t'i falënderoja të gjithë pjesëmarrësit për ndihmesën me diskutimet e tyre dhe për problemet që prezantuan këtu. Në fund të fundit përkthimi është se do të dalim nga kjo tryezë e do të shkojmë të punojmë.

Ku do ta fillojmë? Çfarë do të bëjmë? Do të shikojmë përmirësimet e Rregullores së Kuvendit? Do të shikojmë hartimin e një ligji të ri, ligjit organik? Apo do të shikojmë, sepse nga prezantimet që u bënë këtu, sidomos nga e nderuara Majlinda Dhuka, nga Gledisi, gjithashtu, pashë se duhet të gjejmë një të mesme edhe për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit në Bashkimin Europian, ndërkohë që zëri ngrihet shumë lart për të përmirësuar cilësinë e ligjbërjes, sidomos përfshirjen dhe tërheqjen e opinionëve. Nga ana tjetër kemi nevojë për shpejtësi, sepse Parlamenti mund të përballë me një valë të re. Kjo është deri në vitin 2027, është e shkurtër, reforma do të tentojë për më shumë, por sidoqoftë mund të kemi nevojë për të parë ligje të tjera që lidhen me çështjet e integritetit. Fjala vjen, ligji për rolin e Kuvendit për integritetin në Bashkimin Europian. Tani, këto natyrisht do të meritojnë diskutime të tjera, unë e shikoj si një fazë tjetër diskutimi, sepse të themi do ta spostojmë Rregulloren dhe do të bëjmë një ligj organik, duhet t'i matim gjërat me Kushtetutën. Kjo është e para.

E dyta, kur themi ne duam kohë të konsultohemi e të thithim opinione, duhet t'i matim gjërat, sepse ne e kemi prioritetet integritetin në Bashkimin Europian. Pra, ne kemi shumë prioritete në të njëjtën kohë, prandaj duhet t'i shikojmë me vëmendje të gjitha këto.

Do t'i ftoja të gjithë pjesëmarrësit, në qoftë se kanë mendime dhe opinione konkrete për ndryshime të ligjeve në mënyrë që të gjitha këto ide të vjera që ata shprehën këtu, të pasqyrohen

në ligjet që mund të ndryshohen, të na i paraqesin ato, sepse do të na ndihmonin shumë. Kam parasysh një eksperiencë për ligjin organik për Presidentin e Republikës nga Reforma në Drejtësi, të cilin nuk arritëm ta përfundonim. Prandaj është shumë e nevojshme që të na ndiqni, të na ndiqni dhe të na mbështesni me opinionet tuaja në kuadër të zbardhjes, të transkriptimit, sepse këto ide do të transkribohen në ligjet tona. Kaq kisha.

Ju faleminderit shumë!

Juelda Lamçe – Faleminderit, profesoreshe!

Fjala për zonjën Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Së pari, dua të bëj një falënderim për të gjithë ekspertët që punuan në lidhje me këtë shtyllë, në fakt, këtë pjesë dhe komponent të rëndësishëm, siç është dhe roli i Kuvendit!

Në fakt, puna juaj është kaq e lavdërueshme, sepse nxiti kaq shumë debate me qëllim përmirësimin e punës, por i shërben edhe një qëllimi të madh që ka në tërësi shoqëria shqiptare. Komisioni i Posaçëm është duke punuar pikërisht në kuadër të rrugëtimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Ne po bëhemi gati që të gjitha gjymtyrët e shtetit të jenë të afta për të qenë pjesë e familjes së madhe europiane. Unë kam qasjen se pavarësisht rëndësisë që ka ky proces për të qenë pjesë e Bashkimit Europian, ne kemi dhe detyrën tonë, të gjithë së bashku, të bëjmë më të mirën dhe të arrijmë ato standarde që kërkojnë qytetarët shqiptarë për të pasur më shumë shërbim nga të gjitha gjymtyrët e shtetit, për të pasur standarde, siç i kanë të gjithë qytetarët në Europë, je apo nuk je pjesë e familjes europiane, në kuptimin zyrtar si vendet anëtare. Për këtë jemi duke punuar.

Ndaj e vlerësoj shumë gjithë këtë tryezë gjithëpërfshirëse, ashtu si edhe gjashtë tryezat e tjera, që kanë prekur çështje shumë të rëndësishme që lidhen me mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit. Ne kemi punuar me ekspertët për katër pika në një analizë paraprake, fare paraprake, që lidhet me rolin ligjvënës të Kuvendit, rolin monitorues, zgjedhjen e organeve të pavarura, titullarët e të cilëve apo anëtarët e të cilëve janë kompetencë prerogative e Kuvendit, si edhe në një element shumë të rëndësishëm (më vjen keq se ndoshta për efekt kohe nuk patëm shumë diskutime), që ka të bëjë me llogaridhënien, transparencën e vetë Kuvendit, sepse ndërkohë që Kuvendi në funksionin e vet, si përfaqësuesi i sovranit, ushtron atë fuqi garantuese në emër të popullit që të gjitha institucionet e tjera të shtetit, të gjitha pushtetet e shtetit t'i ushtrojnë funksionet e tyre në interes të qytetarëve, do të duhet, së pari, t'i bëjë një analizë vetes së vet se deri në çfarë

niveli Kuvendi është i aftë t'i përgjigjet kësaj pritshmërie që kanë Kushtetuta, interesi publik dhe qytetarët.

Më vjen mirë, duke i falënderuar pa diskutim të gjithë pjesëmarrësit dhe të gjithë ata që kontribuuan me diskutime, që ne kemi bërë një skaner, do të thosha unë, një radiografi paraprake se ku jemi deri tani me të katër elementet, komponentët e rolit të Kuvendit, siç e shohim ne në këtë material të madh analitik, nga ku do të burojë edhe roli i Kuvendit të nesërmen, në atë pjesë që do të ketë rëndësi edhe për rrugëtimin në familjen europiane.

Thënë këtë, ne sot kemi diskutuar rolin ligjvënës dhe rolin e Kuvendit sa i takon procesit të zgjedhjes së titullarëve apo anëtarëve të institucioneve të pavarura. Kemi folur pak edhe për transparencën dhe llogaridhënien, por ama kemi edhe rolin monitorues, të cilin do ta diskutojmë në tryezën e të premtës. Meqë jemi këtu, gjej rastin t'ju riftoj, por e rëndësishme është të kuptojmë se kemi përparime në shumë fusha dhe për këtë pa diskutim që jemi krenarë, sepse nuk është një proces që lindi sot dhe menjëherë do të shohim treguesit e ecurisë pozitive, është një proces që ka vijuar, dhe sot ne patëm disa arritje që i treguan ekspertët, ashtu sikundër nuk kemi asnjë lloj problemi të themi edhe ku i kemi problemet. Duhet të jemi të hapur, duhet t'i pranojmë edhe sfidat, edhe problematikat që kemi për sa kohë kemi të njëjtat qëllime. Qëllimi është t'i bëjmë sa më mirë funksionet tona. Kur them ne, flas për ata që janë të zgjedhur në Kuvend, flas për stafet e Kuvendit, administratën dhe nëpunësit e shërbimit civil në Kuvend, flas për ekspertët e jashtëm dhe flas për ata, pa të cilët puna e Kuvendit do të ngelej e ftohtë, nuk do të kishte natyrën njerëzore të gjithëpërfshirjes, shoqërinë civile, grupet e interesit, Akademinë, dhomat e biznesit e cilindo grup tjetër interesi, sepse nuk mendoj se shterojnë kur bëhet fjalë për procesin ligjvënës.

Këtu do të ndalem në tri a katër elemente që më duken të rëndësishme për t'u diskutuar. Kryesori është besimi i publikut në këtë proces. Besimi i publikut nuk vjen vetvetiu, nuk vjen se ne organizojmë disa tryeza, se bëjmë disa procese dëgjimore apo se i paraqesim ligjet në faqen e internetit dhe kërkojmë mendime. Procesi vjen me rezultate. Ne kemi një manual për publikimin e akteve dhe për thithjen e mendimit të publikut. Në fakt, ai manual është një hap shumë i mirë përpara, por ka mungesë të mekanizmave se si bëhet ajo që në anglisht quhet *follow up*, vijueshmëria e marrjes së mendimeve. Ne kemi afate kohore, sepse e shoh që janë problem, të cilat nuk i kemi të gdhendura në gur. Ne, afatet kohore, me kërkesë të shoqërisë civile apo aktorëve të ndryshëm, i kemi shtyrë disa herë sa i takon konsultimit publik. Ajo që unë kam parë si problem është se çfarë bëjmë ne me problemet që na vijnë.

Komisioni i Ligjeve ka bërë raporte për mendimet që vijnë nga publiku, qoftë për amendamente apo qoftë për procesin monitorues, por i kemi bërë ne se kështu kemi vendosur me vendim politik në Kuvend. Manuali apo mekanizmat e Kuvendit nuk e kanë këtë proces të shtjelluar nga A-ja te ZH-ja.

Pra, ai që investon kohë, energji, shoqëria civile, sjell një kërkesë për një ndryshim në ligj në procesin ligjvënës, nëse i merret parasysh, ka raportin përfundimtar të projektligjit dhe amendamentin që miratohet në seancë. Po ai grup, amendamenti apo kërkesa e të cilit nuk përfshihet, a do të duhet të ketë një arsyetim me shkrim se cila është arsyeja? Patjetër që po.

Po i ngre këto si çështje për të kuptuar se këto janë gjërat që na duhet t'i shohim në kuadër të përmirësimit të punës sonë. Nëse ne e bëjmë këtë, patjetër që besimi i publikut do të rritet, sepse qytetarët do të jenë të qartë, do të kuptojnë se çfarë u tha, si u mor në konsideratë, sa seriozisht u trajtuan kërkesat dhe mbyllet cikli. E kemi bërë këtë në shumë ligje. T'u them të drejtën nga 44 amendamente 90% janë të Komisionit të Ligjeve, që janë pranuar nga shoqëria civile.

Në fakt, ne kemi bërë edhe një komunikim me ata që kanë qenë propozues, duke u shpjeguar në formë tabelare pse merret parasysh një amendament dhe pse nuk merret, duke dhënë argumentin. Kjo e ka bërë procesin e ndërveprimit real, pra i ka dhënë jetë jetës parlamentare dhe komunikimit të Kuvendit me shoqërinë civile apo me grupet e interesit. Këto janë mekanizma të cilat unë mendoj se ne duhet t'i shohim dhe t'i kemi të sanksionuara. Nuk duhet të lihet në dorë të vullnetit politik të deputetëve, sepse nëse nuk i kemi rregullat të shkruara, u ndryshon qasja nga një deputet tek tjetri, nga një natyrë njeriu te një natyrë tjetër. Për mua këto janë të rëndësishme të shkruhen. E dhashë si shembull jo vetëm për funksionin ligjvënës, por edhe atë monitorues e të tjera.

Tjetra që ka shumë rëndësi, jam shumë dakord me Gencin, sekretarin e Përgjithshëm, i cili, në fakt, bën një punë të lavdërueshme për t'i rritur standardet çdo ditë, por e vërteta është se ne mund të ecim me ritme më të shpejta. *E-legislation*, ILO, që Kuvendi është duke bërë, sipas gjykimit tim, shkon përkrah me rritjen e kapaciteteve të Kuvendit për t'u shërbyer deputetëve. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm me faktin se askush nuk është njësoj me tjetrin, është i rëndësishëm diversiteti, por jo të gjithë ulen dhe shkruajnë.

Ndërkohë, nëse ne normojmë, jo vetëm në Kuvend, por një proces nga fillimi deri në fund, që kur fillon procesi i hartimit të ligjit që në ministritë përkatëse, apo nëse kemi diçka paralele për shoqërinë civile apo për 20 mijë zgjedhës, këtu bie dakord me Iris Luarasin, është shumë i lartë si

numër, por kjo kërkon ndryshime kushtetuese, pra nëse ne arrijmë të kemi një proces të normuar mirë, të çiftuar me *e-legislation*, i cili fillon që në momentin kur diskutohet problematika e hartimit të një projektligji nga nismëtarët e deri kur botohet në Fletoren Zyrtare, i gjithë problemi i transparencës dhe i cilësisë do të përmirësohet, sepse të gjitha materialet do të jenë *online*, mundësia e konsultimit publik do të jetë *online* dhe do të jetë, siç e thotë Gledis Gjipali, më pëlqen fjala, e gjurmueshme çdo hallkë e procesit dhe çdo mendim i dhënë, i cili e përmirëson aktin, por nga ana tjetër merr në konsideratë edhe të gjitha interesat e publikut lidhur me të.

E treta, që do të doja të flisja këtu, ka të bëjë me mekanizmin e gjithëpërfshirjes. Ka të drejtë shoqëria civile, lodhet, harxhon resurse, nuk i kanë të gjithë ekspertët, e kam thënë dhe nuk do të resht së thëni se as Kuvendi nuk i ka të gjithë ekspertët, nuk i ka të gjitha resurset, jo të gjithë ulen e shkruajnë njësoj, madje nuk e di, por në disa raste ata që nuk shkruajnë janë dhe kritikët më të mëdhenj të atyre që shkruajnë, ndërkohë që për shoqërinë civile ky nuk duhet të jetë një problem. Shoqëria civile dhe grupet e interesit, neve do të na duhet të gjejmë një mekanizëm në Kuvend, nuk duhet ta kenë fare shqetësim se si e shkruajnë nevojën që kanë si në procesin ligjvënës, edhe në procesin monitorues, ta shkruajnë siç e mendojnë. Duhet të mendojë Kuvendi se si t'i rrisë kapacitetet që të adresojë në formën që kërkon ligji dhe standardi, patjetër, atë nevojë që ka qytetari. Kjo do ta ulë edhe frenimin që kanë shoqëria civile apo grupe qytetarësh, sepse shoqëri civile nuk janë vetëm OJF-të, shoqëri civile janë të gjithë individët që jetojnë në këtë vend dhe që duan të ngrenë një shqetësim, që t'i sjellin të gjitha komentet që kanë pa pasur projekte apo ekspertiza. Për këtë arsye, në Kuvend ne do të duhet të kemi jo vetëm një koordinator për marrëdhëniet me publikun, por një zyrë asistence, e ngjashme me ndihmën ligjore që kanë sot OJF-të apo ministritë, e kam fjalën për ndihmën parësore ligjore ku u shpjegojnë qytetarëve të drejtat dhe mënyrën se si ti ndjekin. Nuk po flas për ndihmën dytësore, atë që të marrin avokat.

Pra, modele të tilla të ngjashme jo vetëm që e përmirësojnë funksionin, jo vetëm që u vinë në ndihmë qytetarëve, por në të njëjtën kohë nuk është vetëm një punë për ta parë së brendshmi, por një punë që kontribuon së shumti edhe në integrimin e vendit në Bashkimin Europian.

Këto ishin çështjet që do të doja t'i trajtonim dhe t'i shihnim, sepse i çmoj shumë të gjitha diskutimet që u bënë këtu, por do të doja të fokusoheshim te procesi zgjedhës, gjithashtu, sepse atje mund të ketë nevojë për një analizë më të thellë të mënyrës se si kandidatët vlerësohen, përzgjidhen, sepse, po ta shihni, shumë procese përzgjedhëse nuk janë më në dorë të vullnetit politik, por i lihen rastësisë nëpërmjet mekanizmave të zhbllokimit ose janë çështje që kërkojnë

një vullnet gjithëpërfshirës politik, shumicë të cilësuar. Duke u marrë me këto çështje, unë mendoj se duhet të fokusohemi te kriteret e meritokracisë dhe të transparencës për t'i dhënë jetë dhe për të nxitur besimin e kandidatëve të shumtë që të jenë pjesë e proceseve tona dhe pa diskutim ekspertët do të duhet të shohin sa funksionalë i kemi këta mekanizma, që janë të ftohtë, që nuk janë njerëzorë, që nuk lidhen me vullnetin e njerëzve, të cilët do të duhet të japin një vlerësim me votë për kandidatët.

Në fund, shpeshherë dëgjojmë nëpër tavolina kur thonë: epo, kështu është kur zgjidhet me short. Jo, ne kemi mundësi t'i japim procesit jetë dhe më të mirët të jenë atje për të dhënë shërbime në institucionet e pavarura apo kudo tjetër ku Kuvendi e ka rolin e vet.

Thënë këtë, unë ju falënderoj edhe një herë!

Ne do të vijojmë, jemi në fazat paraprake të analizës të draftit fillestar, mendoj se do ta përmirësojmë, kështu që mendimet tuaja do të duhen në vijimësi.

Ju kërkoi ndjesë, sepse ndoshta u zgjatëm, por ishte shumë e vlefshme e gjithë kjo tryezë dhe i gjithë ndërveprimi me të gjithë ju!

Juelda Lamçe – Faleminderit!

Nuk më ngelet gjë tjetër veçse t'ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe për kontributet, të cilat do t'i pasqyrojmë në versionin përfundimtar!

Shume faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit